



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional, në “Bankë dhe Sigurime”

ofruar nga:

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Orkida Ilollari

2. Prof.Asoc.Dr. Ilir Tomorri

Shtator, 2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për programin e studimit Master Profesional, në “Bankë dhe Sigurime”
ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Dep. Financë - Kontabilitet, Fakulteti i Ekonomisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në: “Bankë dhe Sigurime
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 388, datë 10.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 57, datë 15.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 (një) vit / 2 (dy) semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite/ ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE/ 1 PAK: V.A. 2024-2025 11 PAE/ 1 PAK: V.A. 2023-2024 11 PAE/ 1 PAK: V.A. 2022-2023
18	Numri i studentëve:	4 - Studentë: V.A. 2023-2024 8 - Studentë: V.A. 2022-2023 7 - Studentë: V.A. 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, është Institucion i Arsimit të Lartë publik i vendosur në qendër të juglindjes së Shqipërisë, në qytetin e Korçës. Ky universitet, është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 5 datë 07.01.1992 dhe akredituar me Vendim e BA Nr. 02, datë 27.01.2023, me kohëzgjatje 4 vite, për periudhën 27.01.2023 deri 26.01.2027.

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (UNIKO, në vijim të këtij raporti), përbëhet nga katër fakultete/njësi kryesore, përkatësisht:

1. Fakulteti i Bujqësisë,
2. Fakulteti i Ekonomisë,
3. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë,
4. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane.

Ky universitet, ofron programe studimi profesionale, në ciklin e parë të studimeve (Bachelor), ciklin e dytë të studimeve Master Profesional dhe Master i Shkencave dhe në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës.

Fakulteti i Ekonomisë, (FE, në vijim të këtij raporti) është një nga njësitë kryesore të Universitetit "Fan S. Noli". Ky fakultet, përbëhet nga tre departamente:

1. Departamenti i Financë-Kontabilitetit;
2. Departamenti i Menaxhimit;
3. Departamenti i Marketing-Turizëm.

Fakulteti i Ekonomisë për vitin akademik 2024-2025, ofron gjithsej 14 programe studimi: 1 (një) program studimi profesional; 6 (gjashtë) programe studimi në ciklin e parë të studimeve (Bachelor); 6 (gjashtë) programe në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional; dhe 1 (një) program në ciklin e dytë Master i Shkencave.



Programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime" është hapur me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 388, datë 10.07.2018.

Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Financë -Kontabilitet i Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin "Fan S. Noli", në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë, si njësi kryesore, përgjegjëse për programin e studimit.

Programi i studimit, realizohet me një kohëzgjatje 1 (një) vit akademik me 60 kredite. Ky program ofrohet në gjuhën shqipe.

Programi i studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime", ka si qëllim të ofroj studentëve studime të thelluara teorike dhe aftësi praktike në fushën e sektorit bankar, sigurimeve, shërbimeve financiare dhe kontabilitetit.

Ky program studimi synon, të pajis studentët me njohuri të avancuara dhe kompetencat e duhura profesionale për një karrierë të suksesshme në sektorin bankar, kompanitë e sigurimit, si dhe institucione të tjera financiare.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, është përgatitur nga ekspertët; Prof. Asoc. Dr. Orkida Ilollari dhe Prof. Asoc. Dr. Ilir Tomorri, të kontraktuar nga kordinatori teknik i ASCAL.

Për të hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), grupi i ekspertëve u mbështet në një sërë dokumentash që u aksesuan nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, të cilat ishin të përfshira në Dosjen e Vetëvlerësimit për këtë program studimi, të ofruar nga Departamenti i Financë - Kontabilitet i Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë.

Gjithashtu, informacionet dhe të dhënat e nevojshme për hartimin e këtij raporti u plotësuan edhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të ekspertëve gjatë vizitës dy ditore në institucion, nëpërmjet intervistave të zhvilluara me personelin akademik dhe administrativ si dhe studentët e programit të studimit të këtij universiteti.

Për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit grupi i ekspertëve është mbështetur në kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, ekspertët kanë ndjekur një metodologji, bazuar tek analizimi i dokumentave dhe përrputhja e tyre me kriteret dhe kërkesat ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit, Master Profesional në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri.

Vlerësimi i programit të studimit u realizua në përrputhje me kërkesat e raportit të vlerësimit sa i përket fushave, standardeve dhe kriterëve përkatëse, duke u përqendruar në analizën e planit mësimor, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës që përdoret, të dhënave të personelit akademik për këtë program studimi, infrastrukturës në mbështetje të programit, sigurimit të brendshëm të cilësisë, mbështetjes së studentëve, etj.

Vizita 2 ditore në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit “Fan S. Noli”, u realizua gjatë datave 05 & 06/03/2025, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, shoqëruar dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL.

Gjatë kësaj vizite 2- ditore, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u takua me Dekanen e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjësen e Departamentit Financë-Kontabilitet, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), Koordinatorin institucional, stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi.

Gjithashtu, gjatë kësaj vizite u realizuan takimet me përfaqësues dhe punonjës të Drejtorisë së Kurrikulës, Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (DBNj), Sektorit të Projekteve dhe Kërkimit Shkencor (SPKSh), Qendrës së Karrierës dhe Alumnit (QKA), Sekretarisë Mësimore, si dhe vizita në mjediset e IAL_UNIKO (auditorë, bibliotekë, laboratorë dhe shërbimet për studentët, etj.).

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, informacionin dhe të dhënat e mbledhura gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në këtë Institucion.

Më datë 27.06.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 36/80 Prot., datë 27.06.2025, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 04.07.2025, dhe me shkresë zyrtare Nr. 1399/1 Prot., datë 04.07.2025, ka dërguar përgjigje mbi draft raportin, duke u shprehur se nuk ka komente, si rrjedhojë raporti, merr formën përfundimtare, si raport i vlerësimit të jashtëm.

Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional, në “Bankë dhe Sigurime”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, për të shqyrtuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri analizoi përmbajtjen e dy dokumenteve të rëndësishëm në Dosjen e Vetë Vlerësimit (në vijim DVV), Statutin e Institucionit dhe Planin e Zhvillimit Strategjik të Institucionit. Referuar shqyrtimit të dokumentacionit (<i>Statutit të UNIKO, Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO</i>), GVJ konstatoi se programi i studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” është në përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit, që synojnë zhvillimin dhe konservimin e vlerave akademike kombëtare. Ky program studimi nuk bie ndesh me interesat dhe strategjitë kombëtare të ekonomisë dhe zhvillimit të Arsimit të Lartë në vendin tonë. Nëpërmjet këtij program studimi synohet dhe mundësohet, përgatitja e specialistëve në fushën e sektorit bankar dhe të sigurimeve.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar, <i>statutit dhe planit strategjik të zhvillimit të UNIKO</i>, (neni 2, 3), vizioni dhe misioni i këtij Institucioni, ndër të tjera është: të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të ofrojë dijet nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të tjera në fushat e ekonomisë, bujqësisë, shkencave humane dhe sociale, shkencave natyrore dhe shkencave të edukimit. Në planit strategjik të zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë, citohet se misioni i këtij fakulteti është të formoj dhe përgatitë specialistë të ardhshëm që t'i përshtaten situatave konkurruese të tregut nëpërmjet zhvillimit dhe transmetimit të dijeve me anën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. GVJ gjykon se misioni dhe objektivat e programit të studimit, janë në përputhje me fushat e veprimtarisë së Institucionit. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 _Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.3 _Plani Strategjik i Zhvillimit te UNIKO_2022-2027;</i> <i>Dok_Aneks 2.4 _Plani Strategjik i Zhvillimit te FE_2022-2027;</i> <i>Dok_Aneks 2.2 _Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3 _Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5 _Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit (Statutin e Institucionit, <i>Planit Strategjik të Zhvillimit</i> , Rregulloret përkatëse), GVJ konstaton se programi i studimit

zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, është hartuar në përputhje të plotë me planin strategjik të zhvillimit të UNIKO dhe FE-së. Statuti, rregulloret institucionale si dhe rregullorja e programit të studimit, përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të institucionit. Referuar, rregullores së programit të studimit, (pika 3), ky program ka si synim dhe objektiva: të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e sektorit bankar, sigurimeve dhe kontabilitetit; të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale; të përgatisë specialistë të aftë me njohuri të nevojshme në fushën e shërbimeve financiare, sektorit bankar, sigurimeve, kontabilitetit dhe auditimit.			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	GVJ konstaton se, nga analiza e objektivave formues të programit të studimit, janë në përputhje me strategjinë kombëtare dhe prirjet globale të zhvillimit ekonomik. Organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit MP_Bankë dhe Sigurime, është në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO-së, dhe të Fakultetit të Ekonomisë. Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është hartuar në përputhje me standardet e parashikuara në Statutin e UNIKO, duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës dhe punësimin e ardhshëm të studentëve. Si përfundim, në gjykimin e GVJ, përgatitja e specialistëve të aftë dhe pajisja e tyre me njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e e sektorit bankar, sigurimeve dhe kontabilitetit, është në përputhje me strategjinë kombëtare dhe zhvillimet ekonomike në vend. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 _Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.3 _Plani Strategjik i Zhvillimit te UNIKO_2022-2027;</i> <i>Dok_Aneks 2.4 _Plani Strategjik i Zhvillimit te FE_2022-2027;</i> <i>Dok_Aneks 2.2 _Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3 _Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5 _Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023.</i>			
Konkluzione	Programi i studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, është hartuar në përputhje të plotë me misionin, vizionin dhe objektivat e Institucionit, si dhe planin strategjik të zhvillimit të UNIKO dhe FE-së. Ky program studimi ka si synim pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe përgatitjen e specialistëve të aftë në fushën e sektorit bankar, sigurimeve dhe kontabilitetit. GVJ shprehet se ky kriter përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVJ shqyrtoi, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në sistemin AMS të ASCAL (DVV) dhe në mënyrë të veçantë, Statutin e UNIKO-së, Rregulloret institucionale, Rregulloren e programit të studimit si dhe të dhënat tabelare për personelin akademik. GVJ konstaton se Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, ka një përvojë të konsiderueshme, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit. GVJ, referuar shqyrtimit të dokumentacionit përkatës në DVV, (CV-ve si dhe të dhënave tabelare për personelin akademik) konstaton se, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës-Kontabilitetit si njësi bazë, dëshmojnë se kanë kapacitetet e duhura në fushën akademike, mësimdhënëse si dhe përvojën e duhur për ofrimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”. Departamenti i Financës-Kontabilitetit si njësi bazë për këtë program studimi, për vitin akademik 2024-2025, ka në përbërjen e tij 14 pedagogë (PAE dhe PAK), nga të cilët; 5 janë me titullin Profesor i Asociuar; 8 janë me gradën shkencore “Doktor”; dhe 1 në proces doktorature. Kualifikimi dhe përgatitja e stafit është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të Departamentit, si dhe me modulet që mbulohen prej tyre. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3 Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5 Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.9 Jetëshkrimet (CV) e Stafit Akademik ne Programin e Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 4.14 Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” është program studimi i ciklit të Dytë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, i organizuar me 60 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje normale 1 (një) vit akademik. Ky program studimi është hapur me Urdhërin e MASR, Nr. 388, datë 10.07.2018. Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se; fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore (FE) dhe njësisë bazë (DFK) si njësi përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi. Referuar dokumentacionit shoqërues (aneksit për kodifikimin e programeve të studimit) dhe të dhënave të RVB, programi i studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, është kodifikuar me kodin “71MP0412S” në përputhje me kërkesat ligjore të VKM 310/2022. Referuar, Planit Mësimor dhe Kurikulës, lëndët e programit të studimit, janë specifikuar sipas kategorive A-E, në përputhje me kriteret e VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021. GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Referuar dokumentacionit shoqërues, <i>(Statutit të UNIKO-së, neni 7; Rregullores së UNIKO, neni 4,5,)</i> Fakulteti i Ekonomisë (FE) është njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programeve të studimit. Departamenti i Financës-Kontabilitetit (DFK), është njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programin të studimit MP në “Bankë dhe Sigurime”, <i>(Rregullorja e FE, neni 5,6).</i> Fakulteti i Ekonomisë, referuar rregullores (Kreu II, neni 5,6), përbëhet nga 3 (tre) njësi bazë (departamente): 1. Departamenti i Financë-Kontabilitetit; 2. Departamenti i Menaxhimit; 3. Departamenti i Marketing-Turizëm. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë që janë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi. GVJ konfirmon se programi i studimit, MP në “Bankë dhe Sigurime” është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.10_Kodifikimi i Programeve te Studimit_FE_UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	<i>Ky kriter nuk aplikohet.</i>
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Referuar të dhënave të RVB, pranë UNIKO funksionon Qendra e inovacionit (INNOV8), e krijuar në vitin 2018 në kuadër të projektit “Innovation Eco System in the CBC area (CBC INNOV8)”. Gjithashtu si pjesë e strukturës të Fakultetit Ekonomisë, funksionon Qendra SMART e Inovacionit, e krijuar në vitin 2022 në kuadër të projektit “SMART Innovation Centres. Në kuadër të projekteve, pranë këtyre qendrave të inovacionit të UNIKO dhe FE-së, janë zhvilluar disa trajnime me fokus promovimin dhe mbështetjen e modeleve të inovacionit, menaxhimit të SME-ve dhe Start-up-eve, ku pjesëmarrës kanë qenë studentë aktivë dhe të diplomuar, përfaqësues nga bizneset dhe nga autoritetet lokale.

	Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve të realizuara me GVB, P/Dep., dhe përfaqësues të Qendrës së Alumnit dhe Karrierës (QAK), u konfirmua se kjo zyrë, ofron këshillime, seminare dhe informacion mbi zhvillimin e karrierës së tyre profesionale pas përfundimit të studimeve dhe orientimin drejt tregut të punës. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 _Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 2.2 _Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3 _Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5 _Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> https://unkorce.edu.al/nisma-per-mbeshtetjen-e-start-up-ve-permes-financimeve-direkte-nga-palet-te-treat-u-prezantua-per-studente-te-uniko-ne-kuader-te-dites-se-sipermarrjes/.			
Konkluzione	<i>Referuar dokumentacionit përkatës GVJ konstaton se, Fakulteti i Ekonomisë (FE) si njësi kryesore dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit (DFK), si njësi bazë për këtë program studimi, kanë kapacitetet e duhura në fushën akademike, mësimdhënëse dhe shkencore për ofrimin e programit të studimit MP në "Bankë dhe Sigurime".</i> <i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstatoi se UNIKO, ka hartuar dhe miratuar rregulloret e brendshme për mbarëvajtjen dhe funksionimin e njësive akademike dhe ndihmës-akademike. Në rregulloren e njësive bazë, pranë të cilit ofrohet dhe programi i studimit, janë të përcaktuara, funksionet dhe detyrat e njësive bazë, përgjegjësit të Dep., përgjegjësit të grupeve mësimore kërkimore-shkencore, koordinitorit të programit dhe stafit akademik. Për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit, njësia kryesore dhe njësia bazë, koordinojnë dhe bashkëpunojnë për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë midis personelit të angazhuar në veprimtarinë akademike dhe administrative. Këto njësi bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me procesin e mesimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe gjithë ky proces realizohet në mënyrë të koordinuar nga të gjitha hallkat dhe strukturat (përgjegjëse,

	drejtuese dhe mbështetëse). Njësia kryesore dhe njësia bazë, çdo vit kryejnë analizën e punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të cilat janë të depozituara dhe në DVV. Në gjykimin e GVJ, ky kriter përmbushet plotësisht. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023.</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>), GVJ konstatoi se për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe përgatitjen profesionale të studentëve, UNIKO, ka nënshkruar një sërë marrëveshje me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Një bashkëpunim të gjerë UNIKO dhe FE, ka me institucione publike, biznese, sipërmarrje dhe aktorë të tjerë në vend, ku palët angazhohen për shkëmbim eksperience dhe ekspertizë në funksion të përmirësimit të procesit mësimor dhe realizimit të objektivave të programeve të studimit si dhe për tu dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë praktikat profesionale. Në dokumentacion shoqërues të DVV, gjenden të listuara marrëveshjet e bashkëpunimit midis UNIKO-së me IAL brenda dhe jashtë vendit si dhe institucionet partnere, të cilat u konfirmuan edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Në funksion të realizimit të praktikave profesionale për studentët me qëllim plotësimin e objektivave të programit mësimor, UNIKO, FE ka një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucionesh publike, sipërmarrje dhe biznese private, institucione financiare dhe banka, kompani sigurimi, të cilat mundësojnë kryerjen e praktikës profesionale për studentët e këtij programi studimi. UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit për realizimin e projekteve kërkimore - shkencore si dhe mobilitete të stafit akademik dhe studentëve. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorët dhe biznese vendas për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, kërkimin shkencor, përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit, si dhe kryerjen e praktikës profesionale për studentët.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga takimi me P/Departamentit, GVB dhe stafin akademik si dhe verifikimi i dokumentacionit në DVV u konstatua se, Departamenti në mënyrë periodike në fund të vitit, bën analizën e punës mësimore dhe kërkimore shkencore, ku përfshihen edhe rezultatet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet publike dhe aktorë të tjerë, në funksion të realizimit të programit të studimit. Njësia kryesore dhe njësia bazë si njësi përgjegjëse për programin e studimit, harton raportet analitike të përfitimeve nga këto marrëveshje bashkëpunimi,

	merr në konsideratë sugjerimet dhe propozimet e ekspertëve të fushës në funksion të përmirësimit dhe realizimit të objektivave të programit të studimit. Nga takimi me P/Dep. dhe stafin akademik si dhe të dhënave të RVB, Departamenti i Financë-Kontabilitetit, në mënyrë periodike, harton relacione/raporte të përfitimeve nga praktika profesionale pranë bizneseve private, shoqërive të sigurimit dhe bankave të nivelit të dytë, me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023.</i> <i>Dok_Aneks 3.21_Tabela e marreveshjeve institucionale_UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.5_Marreveshje bashkepunimi ne mbeshtetje te praktikave profesionale;</i> <i>Dok_Aneks 3.23_Relacion i perfitimeve nga praktikat profesionale ne funksion te programit te studimit;</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>			
Konkluzione	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe njësia bazë, bashkëpunojnë për veprimtarinë akademike dhe administrative në funksion të realizimit të objektivave të këtij programi studimi. Në rregulloret e njësisë kryesore/bazë dhe programit të studimit, janë të përcaktuara, funksionet dhe detyrat e përgjegjësit të Dep., grupeve mësimore kërkimore-shkencore, koordinatorit të programit dhe stafit akademik. UNIKO dhe FE kanë nënshkruar një sërë marrëveshje me IAL brenda dhe jashtë vendit, me institucione publike, sipërmarrje dhe biznese private, në funksion të realizimit të procesit mësimor, kryerjes së praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor. GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																								
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, rregulloreve të UNIKO, njësisë kryesore/bazë, rregullores së programit të studimit, kurrikulës dhe planit mësimor, GVJ konstaton se, Programi i Studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, është i organizuar në lëndë/module, të detyrueshme dhe me zgjedhje të ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) dhe të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Referuar, rregullores së programit të studimit (neni 7-9), ky program studimi ka një kohëzgjatje, 1 (një) vit akademik, i organizuar në 2 semestra dhe ka në total 60 kredite (ECTS), në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015. GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me lëndë me zgjedhje, të vlerësuara secila me kreditet përkatëse. Kreditet janë përcaktuar për çdo lëndë bazuar në ngarkesën mësimore në auditor si dhe në punën individuale të studentit, për përmbushjen e të gjitha detyrimeve. Referuar të dhënave të kurrikulës dhe planit mësimor, ky program studimi përfshin 11 module, praktikën profesionale dhe mikrotezën. Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat e VKM Nr.41 të ndryshuar (shtojca 1, VKM 185/2021), dhe kategorizimi i lëndëve është si më poshtë:																								
	<table><tr><th>Kategoria</th><th>Komponenti mësimor</th><th>Kërkesat ligjore: Master Profesional</th><th>MP_B&S Kredite</th></tr><tr><td>A</td><td>LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme (1 lëndë)</td><td>5–10% (kredite)</td><td>5 (kredite) 8.3 %</td></tr><tr><td>B</td><td>LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disipinën shkencore (5 lëndë)</td><td>30–40% (kredite)</td><td>24 (kredite) 40%</td></tr><tr><td>C</td><td>LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (4 lëndë)</td><td>20–30% (kredite)</td><td>19 (kredite) 31.7%</td></tr><tr><td>D</td><td>LËNDË PLOTËSUESE – (Gjuhë e huaj dhe praktika profesionale)</td><td>10% (kredite)</td><td>6 (kredite) 10%</td></tr><tr><td>E</td><td>DETYRIME PËRMBYLLËSE (Mikroteza)</td><td>10–20% (kredite)</td><td>6 (kredite) 10%</td></tr></table>	Kategoria	Komponenti mësimor	Kërkesat ligjore: Master Profesional	MP_B&S Kredite	A	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme (1 lëndë)	5–10% (kredite)	5 (kredite) 8.3 %	B	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disipinën shkencore (5 lëndë)	30–40% (kredite)	24 (kredite) 40%	C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (4 lëndë)	20–30% (kredite)	19 (kredite) 31.7%	D	LËNDË PLOTËSUESE – (Gjuhë e huaj dhe praktika profesionale)	10% (kredite)	6 (kredite) 10%	E	DETYRIME PËRMBYLLËSE (Mikroteza)	10–20% (kredite)	6 (kredite) 10%
Kategoria	Komponenti mësimor	Kërkesat ligjore: Master Profesional	MP_B&S Kredite																						
A	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme (1 lëndë)	5–10% (kredite)	5 (kredite) 8.3 %																						
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disipinën shkencore (5 lëndë)	30–40% (kredite)	24 (kredite) 40%																						
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (4 lëndë)	20–30% (kredite)	19 (kredite) 31.7%																						
D	LËNDË PLOTËSUESE – (Gjuhë e huaj dhe praktika profesionale)	10% (kredite)	6 (kredite) 10%																						
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE (Mikroteza)	10–20% (kredite)	6 (kredite) 10%																						

	* Totali	60 Kredite
	<i>GVJ rekomandon, rishikimin e kurrikulës dhe planit mësimor të programit të studimit, sa i përket kategorizimit të lëndëve sipas veprimtarive formuese (A-E), dhe ndarjes sipas semestrave përkatës, duke balancuar dhe harmonizuar njohuritë teorike me ato praktike, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 _Statuti i UNIKO_2022; Dok_Aneks 1.2 _Rregullore e UNIKO_2023; Dok_Aneks 2.2 _Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023; Dok_Aneks 2.3 _Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet FE_2024; Dok_Aneks 2.5 _Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023; Dok_Aneks 2.7 _Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime; Dok_Aneks 3.27 _Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime; Dok_Aneks 4.14 _Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>	
Kriteri 2.Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” (pika 3), objektivat formues të programit ndër të tjera, janë që ti pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale si dhe të përgatisë specialistë të aftë me njohuri të nevojshme në fushën e shërbimeve financiare, sektorit bankar, sigurimeve, kontabilitetit dhe auditimit, për një karrierë të sukseshme profesionale në të ardhmen. Referuar analizës së Planit Mësimor, GVJ konstaton se, ky program studimi, ofron mundësinë që studentët të profilizohen në fushën e sektorit bankar, sigurimeve, shërbimeve financiare, kontabilitetit, duke ofruar module si ato të Portofolit të investimeve, Parashikimi dhe vlerësimi financiar, Rregullimi bankar në Shqipëri, Menaxhimi i sigurimeve dhe fondet e pensionit, Legjislacion dhe mbikqyrje e tregut të sigurimeve, si dhe specifike, si ato të Kontabiliteti i institucioneve dhe instrumentave financiare, Auditim në bankë dhe sigurime. Struktura dhe plani mësimor i këtij programi studimi, synojnë të përcjellin tek studentët njohuri teorike dhe praktike të kërkuara nga tregu i punës me qëllim aftësimin e tyre në profesionin përkatës. Kjo realizohet përmes njohurive të marra gjatë zhvillimit të leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, si dhe praktikave mësimore, duke harmonizuar njohuritë teorike me ato praktike. Studentët pas përfundimit të studimeve, mund të punësohen si: specialistë në sektorin bankar dhe financiar, specialist/analist të tregjeve financiare; specialist të shoqërive të sigurimit, fondeve të pensioneve dhe investimeve, specialistë auditimi; specialistë të sistemit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; financierë pranë bizneseve dhe sipërmarrjeve private. Programi i studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” u ofron studenteve njohuri dhe kompetencat e duhura për një karrierë të suksesshme në sektorin bankar, kompani sigurimi, apo institucione të tjera financiare.	

Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Referuar dokumentacionit shoqërues të DVV, konstatohet se në kurrikulën dhe planin mësimor të programit të studimit është specifikuar qartë se realizimi i praktikës profesionale si lëndë e kategorisë D, dhe vlerësohet me 2 kredite (në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr. 879) dhe realizohet në semestrin e dytë të studimeve. Detyrimet përmbyllëse, për këtë program studimi i referohen përgatitjes së mikrotezës dhe mbrojtjes së diplomës, përfshihen në kategorinë E, dhe vlerësohen me 6 kredite (gjithashtu në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr. 879) dhe kryhet në semestrin e dytë të studimeve. GVJ konfirmon përmbylljen e këtij kriteri. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit të Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit të studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	<i>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</i>
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	<i>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</i>

Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	GVJ konstaton se ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe se UNIKO, nuk ka status të veçantë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, planit mësimor dhe kurikulës së Programit të Studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, GVJ konstaton se, përmbajtja e programit të studimit, struktura e tij, lëndët, shpërndarja e krediteve dhe ngarkesës mësimore janë të ngjashme me programe studimi me të njëjtën fushë studimi ose me emërtime të ngjashme të ofruar nga IAL të tjera në vendin tonë. Kurrikula është hartuar në përputhje me nevojat e profilit dhe në përshtatje me modelet e programeve homologe brenda dhe jashtë vendit.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Sipas analizës së rregullore së programit të studimit, GVJ konfirmon se Programi i studimit MP në “Bankë dhe Sigurime”, është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (shtojca 1, VKM 185/2021); me kohëzgjatje normale një vit akademik me kohë të plotë, organizuar në 2 semestra dhe ka në total 60 kredite (ECTS), në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015. Referuar dokumentacionit shoqërues (aneksit për kodifikimin e programeve të studimit) dhe të dhënave të RVB, programi i studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, është kodifikuar me kodin “71MP0412S” në përputhje me kërkesat ligjore të VKM 310/2022. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3 Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5 Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7 Plani Mesimor i Programit të Studimit MP në Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27 Kurrikula e programit të studimit MP në Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.10 Kodifikimi i Programeve të Studimit_FE_UNIKO.</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit MP në “Bankë dhe Sigurime”, nuk ofrohet si program i përbashkët.

Konkluzione	Programi i Studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, GVJ konstaton se, programi i studimit, është i organizuar në lëndë/module, të detyrueshme dhe me zgjedhje, të ndara sipas veprimtarive formuese dhe të vlerësuara me kredite (ECTS). Objektivat formues specifikë të programit, janë që t'i ofrojë studentëve, studime të thelluara teorike dhe praktike në fushat e sektorit bankar, sigurimeve dhe kontabilitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve					
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, është Fakulteti i Ekonomisë, (FE). Ky fakultet, përbëhet nga tre departamente: 1) Departamenti i Financë-Kontabilitetit; 2) Departamenti i Menaxhimit, dhe 3) Departamenti i Marketing-Turizëm. Departamenti i Financës-Kontabilitetit (DFK), është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”. Referuar dokumentacionit shoqërues, ky departament për vitin akademik 2024-2025, ofron gjithsej 5 (pesë) programe studimi: 2 (dy) programe studimi në ciklin e parë të studimeve (Bachelor), 1 (një) program në ciklin e dytë të studimeve, Master i Shkencave dhe 2 (dy) programe në ciklin e dytë Master Profesional. DFK për vitin akademik 2024-2025, ka në përbërjen e tij 14 pedagogë (PAE dhe PAK), nga të cilët; 5 janë me titullin Profesor i Asociuar; 8 janë me gradën shkencore “Doktor”; dhe 1 në proces doktorature. Të dhënat për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (PAE dhe PAK), për njësinë bazë përgjegjëse (DFK), për programin e studimit, MP “Bankë dhe Sigurime”, sipas viteve akademike, paraqiten si më poshtë:					
Kualifikimi i stafit akademik për Programin e Studimit: MP B&S	2024-2025		2023-2024		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr.	0	0	0	0	0
	Prof. Asoc.	5	0	5	0	4
	Dr./PhD.	6	1	6	1	7
	MSc.	0	0	0	0	0
	Totali	11	1	11	1	1

	Të dhënat për raportet numerike midis personelit akademik efektiv (PAE) dhe personelit akademik me kontratë (PAK) janë: ▪ Për vitin akademik 2024-2025, është në raportin 11/1 ose 91.7% me 8.3%. ▪ Për vitin akademik 2023-2024, është në raportin 11/1 ose 91.7% me 8.3%. ▪ Për vitin akademik 2022-2023, është në raportin 11/1 ose ose 91.7% me 8.3%. Departamenti i Financës-Kontabilitetit si njësi bazë, dëshmon se ka kapacitetet e duhura në fushën akademike, mësimdhënëse si dhe përvojën e duhur për ofrimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime". Referuar shqyrtimit të CV-ve të stafit akademik, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	GVJ, referuar shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të DVV, (Tabelat përmbledhëse, 1,2) konstaton se, Departamenti i Financë – Kontabilitet si njësi bazë ka në përbërjen e tij dhe 1 (një) anëtarë si personel ndihmës akademik. Personeli ndihmës akademik, ndihmon dhe mbështet stafin akademik në realizimin e objektivave të veprimtarive të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe koordinimin e aspekteve administrative, në nivel departamenti.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues (Rregulloreve institucionale, dhe rregullores së njësive bazë, neni 9) si dhe në takimin e realizuar me GVB dhe P/Dep dhe u konfirmua se, Departamenti Financë – Kontabilitet, ka emëruar një personel akademik në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e procesit mësimor dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit të studimit. Detyrat e kordinatorit të programit të studimit janë përcaktuar në Rregulloren e njësive bazë. Koordinator, bashkëpunon me strukturat e tjera përgjegjëse, p/grupeve mësimore, stafin akademik, për mbarrëvajtjen e zhvillimit të procesit mësimor. GVJ konfirmon, përmbushjen e plotë të këtij kriteri. Referenca: Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022; Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023; Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023; Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024; Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023; Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banque dhe Sigurime; Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banque dhe Sigurime; Dok_Aneks 3.26_Programet e studimit te ofruara nga Departamenti Finance-Kontabilitet;

	<i>Dok_Aneks 2.9_Jetëshkrimet (CV) e Stafit Akademik ne Programin e Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.11_Vendimi i njesise baze per emerimin e koordinatorëve te Programeve te Studimit_FE_UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>			
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konfirmon se, njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, MP në "Bankë dhe Sigurime", janë të organizuara në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.</i> <i>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar dhe me eksperiencë akademike. DFK ka të angazhuar personel ndihmës akademik/administrativ, në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive akademike në funksion të programit të studimit. GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ, shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV dhe konstatoi se (Rregullorja e Njesisë Kryesore; Rregullorja e Njesisë Bazë; Rregullorja e Programit të Studimit, Plani Mësimor i Programit të Studimit, etj.), informacionet për elementët e rëndësishëm të programit të studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime", disponohen nga Fakulteti i Ekonomisë, (FE) (njësia kryesore) dhe Departamenti i Financës-Kontabilitetit (DFK), (njësia bazë). Këto informacione janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht. GVJ konfirmoi publikimin e përmbajtjes së programit të studimit, planit mësimor dhe informacione të tjera rreth tij edhe në faqen e internetit/website-n e institucionit. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.26_Programet e studimit te ofruara nga Departamenti Finance-Kontabilitet;</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i> https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-3/ https://unkorce.edu.al/departamenti-i-finance-kontabilitet/

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?fakulteti=fe&tipi=mp&programi=bansig
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit MP në “Bankë dhe Sigurime”, është strukturuar në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Lëndët që janë pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi të ciklit të dytë janë të organizuara në bazë të krediteve me orë të përcaktuara në auditor (në formën e leksioneve dhe seminareve) dhe orëve të pavarura të studentit jashtë auditorit. GVJ konstatoi se elementët e rëndësishëm të programit të studimit janë parashtruar në Rregulloren e Programit të Studimit. Sipas kësaj rregulloreje (nenet 7-9), ky program studimi ka një kohëzgjatje, 1 (një) vit akademik, i organizuar në 2 semestra dhe ka në total 60 kredite (ECTS), në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015. Kreditet janë përcaktuar për çdo lëndë bazuar në ngarkesën mësimore në auditor si dhe në punën individuale të studentit, për përmbushjen e të gjitha detyrimeve. Referuar të dhënave të kurrikulës dhe planit mësimor, ky program studimi përfshin 11 module, praktikën profesionale dhe mikrotezën. Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat e VKM Nr.41 të ndryshuar (shtojca 1, VKM 185/2021), Plani mësimor, përbën dokumentacionin kryesor dhe përfshin elementët e mëposhtëm në përputhje me kriteret e VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021: 1. Emërtimin për secilin modul të këtij programi studimi, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës; 2. Numrin e krediteve për çdo modul; 3. Orët në total për secilin modul dhe raportin e orëve (leksione/ seminare); 4. Detyrimet për secilin modul (leksione; seminare, ushtrime, detyra kursi, etj.); 5. Numrin e orëve për punë individuale. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike dhe përfshin (leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, praktikën profesionale dhe temën e diplomës). Sipas nenit 12 të rregullores së programit të studimit studenti është i detyruar të frekuentojë orët mësimore në masën 75%. Procedurat e vlerësimit të studentëve janë të detajuara në syllabuset e secilës lëndë, bazuar në Rregulloren e FE, DFK dhe Rregulloren e Programit të Studimit (neni 13), përfshijnë (provimin e ndërmjetëm, aktivizimi në seminare, projekte/detyra kursi dhe provimin përfundimtar). Për programin e studimit MP_B&S, referuar planit mësimor, parashikohet që në semestrin e dytë të kryhet praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës/temës diplomës.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme të pranimit në programin e studimit MP në “Bankë dhe Sigurime”, të transferimeve dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në (Statutin e UNIKO, neni 57; Rregulloren e UNIKO, neni 48; Rregulloren e brendshme të FE, neni 52; Rregulloren e Njesisë Bazë, neni 24; Rregulloren e programit të studimit, neni 8). Pranimi i studentëve në këtë program studimi bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në ligj dhe në udhëzimet përkatëse të MASR. Kriteri bazë për pranimin e studentëve në programin e studimit është përfundimi i studimeve të ciklit të parë. Kriteret shtesë për pranimin në ciklin e dytë të studimeve miratohen dhe shpallen çdo vit nga institucioni dhe i dërgohen MAS.

	Në rregulloren e UNIKO, njësisë kryesore dhe njësisë bazë, përcaktohen kriteret për njohjen e krediteve, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Informacionet e nevojshme për kriteret e pranimi dhe transferimit të studimeve publikohen dhe te faqja e web të UNIKO. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.26_Programet e studimit te ofruara nga Departamenti Finance-Kontabilitet;</i> <i>Dok_Aneks 2.22_Kriteret e pranimi ne programin e studimit MP Finance-Kontabilitet dhe Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.23_Per vleresimin dhe ekuivalentimin e dosjeve te kandidateve per transferim studimesh dhe per program te dyte studimi;</i> <i>Dok_Aneks 2.13_Udhezuesi per praktiken profesionale ne programin e Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime_FE_UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 2.31_Udhezuesi i diplomes MP ne Banke dhe Sigurime;</i> https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-3/ https://unkorce.edu.al/departamenti-i-finance-kontabilitet/ https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?fakulteti=fe&tipi=mp&programi=bansig
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar, (Rregulloren e UNIKO, e njësisë kryesore, njësisë bazë dhe Planin Mësimor), por edhe syllabuset e lëndëve të programit të studimit MP në “Bankë dhe Sigurime”, të cilat janë pjesë e DVV. Në përputhje me kriteret e VKM Nr.41, datë 24.01.2018, të ndryshuar, Planin mësimor i programit, përmban të dhëna mbi kategoritë e lëndëve/moduleve, shpërndarjen e lëndëve në vit dhe semestra, kreditet, orët mësimore brenda dhe jashtë auditorit, detyrimet akademike, ngarkesën lëndore, llojin e orëve mësimore (leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, etj), praktikës profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, temën e diplomës, etj. Referuar të dhënave për (Syllabuset/programet e lëndës), GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, si: titulli i lëndës, titullari, ngarkesa në orë dhe kredite, tipologjia e lëndës (kategoria), viti dhe semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, programi i studimit të cilit i përket, temat e lëndës, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të lëndës. Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konfirmua se, studentët informohen nga pedagogu i lëndës/modulit përkatës në javën e parë të mësimi, për të gjithë elementët, përmbajtjen e lëndës, objektivat formues, instrumentat e vlerësimit, format e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit.). Rregullat dhe procedurat e vlerësimit të studentëve janë të detajuara në syllabuset e secilës lëndë, bazuar në Rregulloren e FE, DFK dhe Rregulloren e Programit të

	Studimit, përfshijnë (provimin e ndërmjetëm, aktivizimi në seminare, detyra kursi dhe provimin përfundimtar). Komponentët formues të programit në përgjithësi janë konform formateve të kërkuara sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021. Kjo procedure u konfirmua edhe gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe P/Dep, gjatë vizitës në institucion. <i>GVJ rekomandon që, syllabuset/programet e lëndës, të hartohen në përputhje me formatin dhe kriteret e VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021 (Shtojca Nr. 3, Programi i lëndës).</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Gjatë takimit të GVJ me P/Dep dhe stafin akademik u konfirmua se programi i studimit mund të rishikohet me kërkesë të njësisë bazë që ofron programin si rezultat i zhvillimeve të tregut të punës, dinamikave të brendshme, etj. Në çdo fillim të vitit akademik, stafi akademik përgjegjës për hartimin e syllabuseve të lëndëve përmirëson/rishikon përmbajtjen e programeve të lëndëve, të cilat më pas miratohen nga njësia përkatëse. Në takimin me P/Dep dhe stafin akademik u konfirmua, rishikimi dhe përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret e institucionit, duke marrë në konsideratë propozimet e institucioneve partnere me të cilat institucioni, ka marrëveshje bashkëpunimi me qëllimin rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës. GVJ gjithashtu konstatoi ruajtjen e materialeve të lidhura me programin e studimit. Gjatë takimeve me stafin akademik në lidhje me praktikën e përmirësimit të përmbajtjes dhe organizimit të programit të studimit, konfirmohet angazhimi i vazhdueshëm të stafit akademik në këtë drejtim. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 _Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2 _Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2 _Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3 _Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5 _Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.8_Programet Lendore te Programit te Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime.</i>
Konkluzione	<i>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, ky program studimi, është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore për ciklin e dytë të studimeve sipas Kornizës 7 të KSHK.</i> <i>Bazuar në rregulloren e Programit të Studimit, ky program ka kohëzgjatje, 1 (një) vit akademik, i organizuar në 2 semestra dhe ka 60 kredite (ECTS). Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike e cila përfshin (leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, praktikën profesionale dhe temën e diplomës).</i> <i>Kriteret e përgjithshme të pranimit dhe regjistrimit në programin e studimit MP në "Bankë dhe Sigurime, të transferimeve dhe ekuivalentimit të studimeve, janë</i>

	të përcaktuara në rregulloret përkatëse të institucionit. GVJ rekomandon që, syllabuset/programet e lëndës, të hartohen në përputhje me formatin dhe kriteret e VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021 (Shtojca Nr. 3, Programi i lëndës).GVJ konfirmon përbushjen kryesisht të këtij standardi.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, përmbajtjes të syllabuseve, GVJ mund të konfirmojë se programi i studimit përfshin një kategori lëndësh të formimit të nevojshëm profesional dhe njohuri të lidhura me fushat e sektorit bankar, sigurimeve, shërbimeve financiare dhe kontabilitetit, etj. Elementët e programit të studimit, emërtimi i lëndëve, struktura e vitit akademik, ndarja në orë e kredite është në përputhje me parshikimet ligjore të nenit 70, të ligjit nr. 80/2015 dhe të VKM 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar në VKM nr. 879 datë 18.12.2019. Programet e lëndëve, tregojnë për një mbulim kryesisht të plotë të një larmie njohurish specifike në fushat e sektorit bankar, sigurimeve dhe kontabilitetit, me një ndërthurje të njohurive teorike dhe koncepteve praktike. Struktura dhe plani mësimor i këtij program studimi, në gjykimin e GVJ, synojnë të përcjellin tek studentët formimin teorik dhe praktik si dhe kompetencat profesionale në funksion të punësimit të tyre. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit të GVJ me studentët e këtij program studimi.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe kërkimit shkencor.	Objektivat formues të programit të studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” ndër të tjera, janë që ti pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, me kompetenca profesionale si dhe të përgatisë specialistë të aftë me njohuri të nevojshme në fushat përkatëse, për një karrierë të sukseshme profesionale në të ardhmen. Struktura dhe plani mësimor i këtij programi studimi, synojnë të përcjellin tek studentët njohuri teorike dhe praktike të kërkuara nga tregu i punës me qëllim aftësimin e tyre në profesionin përkatës. Kurrikula dhe plani mësimor është i strukturuar në mënyrë të tillë; duke i ndarë lëndët në: lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë me zgjedhje, lëndë plotësuese (praktika profesionale) si dhe detyrimet përmbyllëse (përgatitja e mikrotezës). Referuar të dhënave të kurrikulës dhe planit mësimor, ky program studimi përfshin 11 module, praktikën profesionale dhe mikrotezën.

	Në hartimin e kurrikulës dhe planit mësimor të programit të studimit janë ruajtur raportet e shpërndarjes së krediteve sipas kategorisë së disiplinave përkatëse. Kreditet janë përcaktuar për çdo lëndë bazuar në ngarkesën mësimore në auditor si dhe në punën individuale të studentit, për përmbushjen e të gjitha detyrimeve. GVJ konfirmon se, plani mësimor, lëndët-modulet, shpërndarja në vit e semestra, mundëson arritjen e objektivave formues të programit studimit. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banque dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.8_Programet Lendore te Programit te Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime.</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banque dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>																					
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	GVJ, konfirmon se struktura e programit të studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, plani mësimor, programet e lëndëve dhe raporti i zhvillimit të mësimi midis teorisë dhe praktikës mësimore janë në përputhje me drejtimin dhe profilin e fushave të tij. Struktura dhe plani mësimor i këtij programi studimi, synojnë të përcjellin tek studentët njohuri të thelluara teorike dhe praktike, pajisjen me kompetenca profesionale, si specialistë të aftë në fushën e sektorit bankar, sigurimeve dhe kontabilitetit. Gjatë vizitës të GVJ në institucion, studentët u shprehën se përmbajtja e lëndëve dhe njohuritë e fituara nga ky program studimi, mundëson punësimin e tyre në tregun e punës.																					
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, struktura dhe plani mësimor i këtij program studimi, në gjykimin e GVJ, synojnë të përcjellin tek studentët formimin teorik dhe praktik të nevojshëm të studentëve në funksion të punësimit të tyre. Struktura e programit MP në “Bankë dhe Sigurime”, referuar të dhënave në planin mësimor dhe kurrikulës së programit (lidhur me veprimtaritë formuese, ngarkesa totale në auditor dhe punë individuale) paraqiten në si më poshtë: <table><tr><th>Nr</th><th>Emërtimi i vep. formuese</th><th>Ngarkesa/orë</th></tr><tr><td>1</td><td>Leksione</td><td>398 orë</td></tr><tr><td>2</td><td>Seminare, ushtrime, detyra kursi, etj.</td><td>183 orë</td></tr><tr><td>3</td><td>Praktika profesionale</td><td>50 orë</td></tr><tr><td>4</td><td>Mikroteza/tema e diplomës</td><td>150 orë</td></tr><tr><td>5</td><td>Punë individuale</td><td>719 orë</td></tr><tr><td>*</td><td>Totali</td><td>1.500 orë</td></tr></table>	Nr	Emërtimi i vep. formuese	Ngarkesa/orë	1	Leksione	398 orë	2	Seminare, ushtrime, detyra kursi, etj.	183 orë	3	Praktika profesionale	50 orë	4	Mikroteza/tema e diplomës	150 orë	5	Punë individuale	719 orë	*	Totali	1.500 orë
Nr	Emërtimi i vep. formuese	Ngarkesa/orë																				
1	Leksione	398 orë																				
2	Seminare, ushtrime, detyra kursi, etj.	183 orë																				
3	Praktika profesionale	50 orë																				
4	Mikroteza/tema e diplomës	150 orë																				
5	Punë individuale	719 orë																				
*	Totali	1.500 orë																				

	Këto raporte sigurojnë një ndërthurje të njohurive teorike dhe koncepteve praktike, (leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, praktikën profesionale dhe temën e diplomës), u mundëson studentëve të formohen nga ana profesionale dhe të arrijnë objektivat e të nxënësve në këtë program studimi. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në këtë program studimi, mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitete dhe punësimin e studentëve në përfundim të studimeve. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Referuar dokumentacionit shoqërues në DVV si dhe në takimin e realizuar me Përgj. e Departamentit dhe stafin akademik që zhvillojnë mësim në këtë program studimi, u konfirmua se syllabuset/programet e lëndëve përditësohen në mënyrë periodike. Referuar të dhënave/aneksit për (Programet e lëndës), GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, si: titulli i lëndës, titullari, ngarkesa në orë dhe kredite, tipologjia e lëndës (kategoria), viti dhe semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, programi i studimit të cilit i përket, temat e lëndës, literaturën bazë dhe mbështetëse, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të lëndës. Nga shqyrtimi, që GVJ i bëri përmbajtjes së dosjes së syllabuseve, u konstatua se ato në përgjithësi, garantojnë marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme nga studentët në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. <i>GVJ rekomandon, përditësimin në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme të literaturës bazë dhe ndihmëse të syllabuseve/programmeve të lëndës nga stafi akademik.</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.8_Programet Lendore te Programit te Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime.</i>

Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Në gjykimin e GVJ, përmbajtja e programit të studimit, MP në “Bankë dhe Sigurime”, elementët e tij garantojnë plotësisht përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara nga ana e studentëve siç edhe janë shprehur në Rregulloren e programit të studimit. Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, në gjykimin e GVJ, synojnë të përcjellin tek studentët formimin teorik dhe praktik të nevojshëm në funksion të punësimit të tyre; si specialistë në sektorin bankar dhe financiar, specialist të shoqërive të sigurimit, fondeve të pensioneve dhe investimeve, specialistë auditimi; specialistë të sistemit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; financierë pranë bizneseve dhe sipërmarrjeve private. Programi i studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” u ofron studenteve njohuri dhe kompetencat e duhura për një karriere të suksesshme në sektorin bankar, kompanitë e sigurimit, apo institucione të tjera financiare.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga analiza e përmbajtjes së programit të studimit, MP në “Bankë dhe Sigurime”, GVJ konstaton se ky program, ofron mundësinë e punësimit për studentët në përputhje me profilin e programit të studimit dhe pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>Listës së marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>), GVJ konstatoi se UNIKO dhe FE ka një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucioneve publike, sipërmarrje dhe biznese private, institucione financiare dhe banka, kompani sigurimi, ku palët angazhohen për shkëmbim eksperience në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit, për tu ofruar mundësi studentëve për zhvillimin e praktikave profesionale, si dhe për tu punësuar, mbas përfundimit të studimeve. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023.</i> <i>Dok_Aneks 3.21_Tabela e marreveshjeve institucionale_UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.5_Marreveshje bashkepunimi ne mbeshtetje te praktikave profesionale;</i> <i>Dok_Aneks 3.23_Relacion i perfitimeve nga praktikat profesionale ne funksion te programit te studimit;</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se organizimi, struktura dhe përmbajtja e elementëve të programit të studimit MP në “Bankë dhe Sigurime”, synojnë të përcjellin tek studentët njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Nga shqyrtimi i shpërndarjes së lëndëve në vite e semestra, kurrikula dhe plani mësimor, mundëson arritjen e objektivave formues të këtij programi studimi. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Referuar RVB të përgatitur për këtë kriter si dhe gjatë vizitës në Institucion, përfaqësues të departamentit u shprehën se përditësimi i përmbajtjes së programit ishte një aktivitet periodik dhe në përputhje me zhvillimet dhe kërkesat e tregut të punës. Në takimin me P/Dep dhe stafin akademik u konfirmua, rishikimi dhe përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit, duke marrë në konsideratë propozimet e institucioneve partnere me të cilat institucioni, ka marrëveshje bashkëpunimi. Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>Listës së marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>), GVJ konstatoi se UNIKO dhe FE, ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, sipërmarrje dhe biznese private, institucione financiare dhe banka, kompani sigurimi, ku palët angazhohen për shkëmbimin e eksperiencës dhe ekspertizës në funksion të realizimit të objektivave të programeve të studimit. Gjatë vizitës në institucion të GVJ, u konfirmua se strukturat përkatëse dhe përgjegjëse, marrin në konsideratë propozimet e institucioneve partnere, dhe aktorëve të tjerë për të përmirësuar përmbajtjen dhe strukturën e programit të studimit në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si dhe gjatë takimeve të realizuara nga GVJ me përfaqësues të Qendrës së Karrierës dhe Alumni, u konfirmua se UNIKO, njësia kryesore dhe njësia bazë mbajnë kontakte dhe shkëmbejnë mendime në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Qendra e Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me struktura të tjera institucionale si NjSBC, sekretarinë mësimore, mban kontakte të vazhdueshme (përmes emailit, tel, rrjeteve sociale) lidhur me gjurmueshmërinë e studentëve të diplomuar, sa i përket punësimit dhe karrierës së tyre profesionale. QKA mban kontakte me studentët e diplomuar, organizon pyetësorë me këta studentë dhe tërheqin mendime, sugjerime apo propozime për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Studimet e tregut janë një element i rëndësishëm që i shërbejnë rishikimit të programit të studimit me qëllim, përmirësimin e përmbajtjes së tij në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Studimet e tregut janë realizuar me studentët aktual, studentët alumni, specialistët e fushës së financës, sektorit bankar dhe sigurimeve, të punësuar dhe punëdhënës të bizneseve dhe institucioneve të rajonit të Korçës e më gjerë, etj.

	Njësia kryesore dhe njësia bazë, mbledhin të dhëna në mënyrë periodike për studentët e diplomuar lidhur me punësimin dhe karrierën e tyre, organizojnë takime, diskutojnë dhe tërheqin mendime apo propozime për vlerësimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Referuar dokumentacionit shoqërues dhe RVB të përgatitur për këtë kriter, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe njësia bazë, kanë organizuar në mënyrë periodike aktivitete konsultative, tryeza të rrumbullakta, takime, workshope, leksione të hapura me përfaqësues të institucioneve publike, bizneseve dhe sipërmarrjeve private, specialistë dhe ekspertë të fushës, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës dhe ofrimin e ekspertizës në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Në takimim e GVJ me P/Dep dhe stafin akademik, u konfirmua se strukturat përgjegjëse, marrin në konsideratë, mendimet, sugjerimet dhe propozimet e përfaqësuesve të institucioneve partnere, për të përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023.</i> <i>Dok_Aneks 3.21_Tabela e marreveshjeve institucionale_UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.5_Marreveshje bashkepunimi ne mbeshtetje te praktikave profesionale;</i> <i>Dok_Aneks 3.22_Propozime te diskutuara ne mbledhjet e departamentit ne kontekst te ndryshimeve te programeve lendore, te programeve te studimit;</i> <i>Dok_Aneks 3.22-a_Studim tregu ne kuader te hapjes se programit te studimit MP ne Banque dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.23_Relacion i perfitimeve nga praktikat profesionale ne funksion te programit te studimit;</i> <i>Dok_Aneks 3.29_Pyetesor Alumni dhe relacion mbi veprimtarine per gjurmimin e studenteve te diplomuar;</i> <i>Dok_Aneks 3.9_Analiza vjetore e veprimtarise mesimore per vitin akademik per FE_2022-2023;</i> <i>Dok_Aneks 4.11_Veprimtari te organizuara nga Dep. Finance-Kontabilitet, (Leksione te hapura, tryeza te rrumbullaketa, etj);</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>
Konkluzione	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konfirmon se, UNIKO është i angazhuar në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të kurrikulave dhe përmbajtjes së programeve të studimit, duke marrë në konsideratë, propozimet e përfaqësuesve të institucioneve partnere me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë takimeve të realizuara nga GVJ me përfaqësues të Qendrës së Karrierës dhe Alumni, u konfirmua se kjo zyrë mban kontakte me studentët e diplomuar.

	UNIKO, përfshin studentët në vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe cilësisë së programeve të studimit, etj. Njësia kryesore dhe njësia bazë në bashkëpunim me zyra e struktura të tjera, kryejnë studime tregu në mënyrë periodike për të vlerësuar përmbajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit. GVJ shprehet për përmbushjen plotësisht të këtij standardi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Referuar, shqyrtimit të Rregullores së programit të studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” (pika 3), objektivat formues të programit ndër të tjera, janë që ti pajisë studentët me konceptet bazë, studime të thelluara teorike dhe praktike, me aftësi dhe njohuritë e nevojshme akademike, për një karrierë të sukseshme profesionale në të ardhmen. Ky program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuri të avancuara teorike dhe koncepte praktike, me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale si dhe të përgatisë specialistë të aftë, që t’u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të tregut të punës në fushën e shërbimeve financiare, sektorit bankar, sigurimeve, kontabilitetit dhe auditimit. GVJ gjykon se organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat e institucionit, si dhe planin strategjik të zhvillimit të UNIKO dhe FE-së.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga shqyrtimi i Statutit, Rregullores të UNIKO-së si dhe Rregullores së njësive kryesore dhe Njesisë bazë, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë (FE) si njësi kryesore dhe Departamenti i Financës-Kontabilitetit (DFK), si njësi bazë që ofrojnë programin e studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Autonomia dhe liria akademike janë të garantuara dhe ato bazohen në Statutin e UNIKO, si dhe rregulloret institucionale. Liria akademike sigurohet nëpërmjet të drejtës së personelit akademik: për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, punës kërkimore shkencore, të inovacionit, të transferimit të njohurive si dhe veprimtaritë krijuese. Në takimin e realizuar nga GVJ me stafin akademik të këtij programi studimi, u konfirmua se departamenti nxit, mbështet dhe respekton lirinë akademike të stafit akademik në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies (fleksibilitetin e organizimit të orëve mësimore dhe metodologjive didaktike), në punën kërkimore-shkencore, pjesëmarrjen në projekte të ndryshme në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj si dhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe kualifikimin e tyre.

	Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.3_Plani Strategjik i Zhvillimit te UNIKO_2022-2027;</i> <i>Dok_Aneks 2.4_Plani Strategjik i Zhvillimit te FE_2022-2027;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nga të dhënat e RVB, si dhe takimet në institucion u konfirmua se, njësi bazë që ofron programin e studimit MP_B&S, nxit dhe motivon studentët që të angazhohen në projekte studimore dhe kërkimore, aktivitetet institucionale si edhe projektet e bashkëpunimit institucional. Fakulteti i Ekonomisë, pjesë e rëndësishme e të cilit është edhe Departamenti i Financë-Kontabilitet, në mbështetje të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor, ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit si dhe me institucione publike dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm brenda vendit. Gjatë takimeve të GVJ, me studentët e këtij programi studimi u konfirmua përfshirja e tyre, në projekte, aktivitete kërkimore, konferenca shkencore, etj. Nga takimi i realizuar me pedagogët e këtij programi studimi u konfirmua se stafi akademik nxit dhe motivon studentët të angazhohen në projekte kërkimore duke u bërë pjesë e tyre. Studentët e këtij programi studimi me nxitjen dhe mbështetjen e pedagogëve të departamentit kanë marrë pjesë në konferencat shkencore të organizuara nga UNIKO dhe universitete të tjera. GVJ formon opinionin se ky kriter përmbushet plotësisht.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Referuar të dhënave të RVB si dhe gjatë takimit me stafin akademik, u konfirmua se mbështetur në prioritetet e kërkimit të përcaktuara në departament, njësi kryesore/bazë harton Planin strategjik të kërkimit shkencor të detajuar sipas viteve. Propozimet për veprimtaritë e parashikuara në planin vjetor të punës kërkimore-shkencore, nga grupet mësimore dhe kërkimore, dërgohen në dekanat për miratim dhe financim nga buxheti i Universitetit. Referuar, (statutit, plani strategjik të zhvillimit të UNIKO –së, rregulloreve institucionale), citohet se institucioni, angazhohet që të mbështesë financiarisht njësinë bazë, për aktivitetet studimore, kërkimore dhe shkencore. Në takimin e GVJ me dekanin e FE, përgj/departamentit dhe stafin akademik, u konfirmua mbështetja financiare nga institucioni, për njësinë bazë dhe stafin akademik, lidhur me pjesëmarrjen në projekte kërkimore, organizimin e konferencave shkencore, botimin e artikujve në revista shkencore me faktor impakti, scopus si dhe konferenca shkencore. GVJ formon opinionin se ky kriter përmbushet plotësisht. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.3_Plani Strategjik i Zhvillimit te UNIKO_2022-2027;</i> <i>Dok_Aneks 2.4_Plani Strategjik i Zhvillimit te FE_2022-2027;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i>

	<i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.1_Lista e projekteve te zbatuara nga FE_UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 2.20_Analiza vjetore e veprimtarise mesimore, kerkimore-shkencore e nderkombetarizimit te UNIKO_2022-2023;</i> <i>Dok_Aneks 3.9_Analiza vjetore e veprimtarise mesimore per vitin akademik per FE_2022-2023;</i> <i>Dok_Aneks 4.11_Veprimtari te organizuara nga Dep. Finance-Kontabilitet;</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se, objektivat e programit të studimit janë në përputhje me misionin, prioritetet dhe objektivat madhorë të institucionit. Institucioni, mbështet dhe respekton lirinë akademike të stafit akademik.</i> <i>Programi i studimit nxit, motivon dhe u mundëson studentëve pjesëmarrjen në studime, aktivitete dhe projekte kërkimore - shkencore.</i> <i>Gjatë takimeve me stafin akademik u konfirmua mbështetja financiare nga institucioni, lidhur me pjesëmarrjen në projekte kërkimore, konferenca shkencore, botimin e artikujve shkencorë, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, si dhe takimit me përfaqësues të Sektorit të Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, u konfirmua se ky sektor siguron dhe mbështet njësitë kryesore/bazë dhe stafin akademik për aplikimin në projekte kërkimore-shkencore në nivel kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky sektor ka si objektiv të saj, menaxhimin dhe pjesëmarrjen në projekte, ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, nxitjen e bashkëpunimit me partnerë të huaj, rritjen e vizibilitetit, asistencën e stafit akademik për aplikimin në projekte, etj, bashkërendimin e aktiviteteve me partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit. Në rregulloren e DFK (nenet 5-8), janë të përcaktuara, funksionet dhe detyrat e njësive bazë, përgjegjësit të Dep, përgjegjësve të grupeve mësimore kërkimore-shkencore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues, GVJ konstaton se; njësia kryesore dhe njësia bazë mbështet grupet mësimore, kërkimore-shkencore dhe siguron bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore si Sektor i Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, për pjesëmarrjen në projekte dhe aktivitete të kërkimit shkencor për realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” si dhe fushave të përcaktuara për kërkim shkencor, departamenti nxit stafin akademik të aplikojnë në projekte dhe

	mundëson në të njëjtën kohë bashkëpunimin midis tyre si dhe pjesëmarrjen e studentëve në këto projekte. Departamenti i Financë-Kontabilitet ka aplikuar dhe fituar disa projekte institucionale të financuara nga UNIKO. GVJ formon opinionin se ky kriter përmbushet plotësisht.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	GVJ, konstaton se institucioni mbështet dhe nxit personelin akademik për t'u angazhuar në studime, aktivitete dhe projekte me karakter kërkimor dhe shkencor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Referuar RVB të përgatitur nga institucioni, njësia bazë (DFK), krijon të gjithë lehtësitë dhe kushtet e nevojshme në mbështetje të stafit akademik për përrshirjen dhe angazhimin e tyre në aktivitete dhe projekte me karakter kërkimor-shkencor. Një nga objektivat e kërkimit shkencor dhe veprimtarisë kërkimore të institucionit, është dhe fokusi i tij tek studentët, duke u dhënë mundësinë që të angazhohen dhe të nxiten për të marrë pjesë në aktivitete dhe projekte kërkimore shkencore. Gjatë takimeve me P/Dep, stafin akademik, dhe përfaqësues të institucionit, GVJ konstatoi, pjesëmarrjen e stafit akademik si dhe studentëve në aktivitete dhe konferenca shkencore, si dhe në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Duke analizuar dokumentacionin në DVV, si dhe RVB të përgatitur nga institucioni, GVJ konkludon se, Departamenti i Financë-Kontabilitet, si njësi bazë, lidhur me kërkimin shkencor, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit, organizon konferenca shkencore, simpoziume, seminare etj, që i shërbejnë thellimit të dijeve shkencore të stafit akademik dhe studentëve për arritjen e objektivave në kërkimin shkencor. Në takimet e realizuara gjatë vizitës së GVJ në institucion, u konfirmua pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në projekte kërkimore, konferenca shkencore të organizuara në nivel universiteti dhe fakulteti. Gjatë takimeve me P/Dep, stafin akademik u konfirmua se Departamenti ka krijuar tashmë një përvojë të mirë në organizimin e leksioneve të hapura me specialist dhe ekspertë të fushës; tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues nga institucionet partnere, ku diskutohen probleme që kanë lidhje me fushën specifike të programit të studimit dhe jepen mendime dhe propozime për përmirësimin e tyre. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.3_Plani Strategjik i Zhvillimit te UNIKO_2022-2027;</i> <i>Dok_Aneks 2.4_Plani Strategjik i Zhvillimit te FE_2022-2027;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.1_Lista e projekteve te zbatuara nga FE_UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 2.20_Analiza vjetore e veprimtarise mesimore, kerkimore-shkencore e nderkombetarizimit te UNIKO_2022-2023;</i> <i>Dok_Aneks 3.9_Analiza vjetore e veprimtarise mesimore per vitin akademik per FE_2022-2023;</i>

Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<i>Dok_Aneks 4.11_Veprimtari te organizuara nga Dep. Finance-Kontabilitet.</i> Referuar, Rregullores së programit të studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” (pika 3), objektivat formues të programit të studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” ndër të tjera, janë që ti pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale si dhe të përgatisë specialistë të aftë në fushën e shërbimeve financiare, sektorit bankar, sigurimeve, kontabilitetit dhe auditimit, që t’u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të tregut të punës. Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, në gjykimin e GVJ, synojnë të përcjellin tek studentët formimin teorik dhe praktik të nevojshëm në funksion të punësimit të tyre; si specialistë në sektorin bankar dhe financiar, në kompanitë e sigurimit, fondeve të pensioneve dhe investimeve, specialistë auditimi; specialistë të sistemit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; financiarë pranë bizneseve dhe sipërmarrjeve privat. Ky program studimi, ofrohet nga një staf akademik që është i kualifikuar, dhe me eksperiencë akademike në fushën e sektorit bankar, sigurimeve dhe kontabilitetit.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Referuar dokumentacionit shoqërues dhe të dhënave të RVB, njësitet përgjegjëse, marrin në konsideratë propozimet dhe rekomandimet e institucioneve partnere, dhe aktorëve të tjerë për të përmirësuar përmbajtjen dhe strukturën e programit të studimit, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. Në dijeninë e GVJ, fusha në të cilën ofrohet ky program studimi, nuk parashikon marrjen e një licence për ushtrimin e profesionit. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023.</i> <i>Dok_Aneks 3.21_Tabela e marreveshjeve institucionale_UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.5_Marreveshje bashkepunimi ne mbeshtetje te praktikave profesionale;</i> <i>Dok_Aneks 3.22-a_Studim tregu ne kuader te hapjes se programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.23_Relacion i perfitimeve nga praktikat profesionale ne funksion te programit te studimit.</i>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	<i>Në gjykimin e GVJ, ky kriter nuk zbatohet dhe përfshin programin e studimit MP në “Bankë dhe Sigurime”.</i>

Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, njësia kryesore dhe njësia bazë mbështet grupet mësimore, kërkimore-shkencore dhe siguron bashkëpunim me struktura të tjera për pjesëmarrjen në aktivitete dhe projekte të kërkimit shkencor.</i> <i>Programi i studimit, MP në "Bankë dhe Sigurime", synon të përgatisë dhe formojë specialistë të aftë, që t'u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të tregut të punës në nivel qendror dhe lokal.</i> <i>Njësitë përgjegjëse, marrin në konsideratë propozimet dhe rekomandimet e institucioneve partnere për të përmirësuar në vazhdimësi, përmbajtjen dhe strukturën e programit të studimit me qëllimin, rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Rregulloret institucionale dhe Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në Bankë dhe Sigurime (neni, 13), parashikojnë format e mësimdhënies dhe detyrimet e studentit ndaj lëndës. Veprimtaria mësimore në planin mësimor dhe në programet e lëndëve, si forma të mësimdhënies/mësimnxënies përfshin, (leksione, seminare, ushtrime, esetë, projekte/detyra kursi, praktikën profesionale dhe temën e diplomës). Në programin e studimit të ciklit të dytë Master profesional në Bankë dhe Sigurime, metodat e mësimdhënies/mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive kanë si synim orientimin e mësimimit me qendër studentin, në drejtim të përmbajtjes, metodave dhe teknologjisë që përdoret për realizimin e tyre. Referuar të dhënave/aneksit për (Programet e lëndës), GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, si: titulli i lëndës, titullari, ngarkesa në orë dhe kredite, tipologjia e lëndës (kategoria), viti dhe semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, programi i studimit të cilit i përket, temat e lëndës, literaturën bazë dhe mbështetëse, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të lëndës.

	Komponentët formues të programit në përgjithësi janë konform formateve të kërkuara sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021. Procedurat e vlerësimit të studentëve janë të detajuara në syllabuset e secilës lëndë, bazuar në Rregulloren e FE, DFK dhe Rregulloren e Programit të Studimit (neni 13), përfshijnë (provimin e ndërmjetëm, aktivizimi në seminare, projekte/detyra kursi dhe provimin përfundimtar). Sipas nenit 12 të rregullores së programit të studimit studenti është i detyruar të frekuentojë orët mësimore në masën 75%. Infrastruktura institucionale që është në funksion të këtij program studimi dëshmon për kushte të optimale të zhvillimit të programit mësimor. Përdorimi i metodave innovative, mjeteve bashkëkohore, (pajisjeve audio-vizive kompjuter, laptop, projektor, etj.) apo edhe platformave të ndryshme që mundësojnë realizimin e aktiviteteve të mësimi, ndikon në performancën e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Referuar Rregullores së Programit të Studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, format e mësimdhënies janë të larmishme duke përfshirë (leksione, seminare, ushtrime, projekte/detyra kursi), ç’ka, në gjykimin e GVJ ofron mënyra të ndryshme dhe nxitëse për mësimnxënie nga ana e studentëve. Personeli akademik përdor forma, mënyra dhe metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies për tju përgjigjur nevojave të studentëve. Stafi akademik përveç metodave klasike (leksione, seminare, ushtrime), përdorin një shumëllojshmëri formash të mësimdhënies si (rastet studimore, diskutimet, esetë, detyrat/projektet e kursit), për të motivuar dhe nxitur studentët brenda dhe jashtë auditorit. Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konfirmua se, synohet nxitja dhe zhvillimi i mësimi në mënyrë interaktive me studentët gjatë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, përmes aktivizimit dhe diskutimeve, punës individuale dhe në grup, përgatitjes së detyrave/projekteve të kursit. GVJ shprehet për përmbushjen e këtij kriteri. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.8_Programet Lendore te Programit te Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Për përmbushjen e këtij kriteri, nga shqyrtimi i RVB, institucioni i kushton një rëndësi përmirësimit të vazhdueshëm të aftësive pedagogjike dhe didaktike të stafit akademik.

	Për këtë qëllim, UNIKO dhe FE duke pasur në fokus efektivitetin në mësimdhënie kanë mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nevojat e stafit për përmirësimin e kompetencave didaktike, nëpërmjet promovimit të praktikave më të mira të mësimdhënies, organizimit të leksioneve të hapura dhe përvojës të fituara nga institucione homologe. Referuar të dhënave të RVB, UNIKO përmirëson infrastrukturën e mësimdhënies, nëpërmjet krijimit dhe mbështetjes teknike të aplikacioneve online të komunikimit, nëpërmjet krijimit dhe mbështetjes teknike të laboratorëve për mësimin online si dhe praktikatat mësimore. Si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit të UNIKO-së me universitete partnere ndërkombëtare në kuadrin e kërkimit shkencor dhe marrëveshjeve së mobiliteteve Erasmus +, stafi akademik, ka përfituar dhe përmirësuar kompetencat didaktike nga shkëmbimi i eksperiencës, dhe praktikave më të mira të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë vizitës në institucion, u konfirmua se stafi akademik angazhohet për të qenë vazhdimisht në mbështetje të studentëve nëpërmjet informimit të vazhdueshëm të tyre në lidhje me mundësitë, si internshipe, konferenca etj.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ, shqyrtoi CV-të e stafit akademik lidhur me formimin akademik dhe profesional të stafit të angazhuar në programin e studimit MP në “Bankë dhe Sigurime”, konfirmon kompetencat akademike dhe përgatitjen profesionale për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve në funksion të arritjes së objektivave të të nxëniet për studentët e këtij programi studimi. Departamenti i Financës-Kontabilitetit, si njësi bazë për këtë program studimi, për vitin akademik 2024-2025, ka në përbërjen e tij 14 pedagogë (PAE dhe PAK), nga të cilët; 5 janë me titullin Profesor i Asociuar; 8 janë me gradën shkencore “Doktor”; dhe 1 në proces doktorature. GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim. Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konfirmua se, pedagogët përdorin metoda inovative dhe të larmishme në mësimdhënie për të nxitur pjesëmarrjen e tyre përmes aktivizimit dhe diskutimeve në seminare, punës individuale dhe në grup, rasteve studimore, esseve, detyrave/projekteve të kursit, etj. Profili i stafit akademik, që angazhohet në mësimdhënie është në përputhje me nevojat dhe objektivat e këtij programi studimi. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i>

	<i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.8_Programet Lendore te Programit te Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime.</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Në takimin e realizuar nga GVJ me GVB dhe përfaqësues të Njesisë Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, u konfirmua se institucioni përmes strukturave përkatëse ofron përfshirjen e studentëve përmes instrumentave të ndryshëm (anketimet, pyetësorët) në vlerësimin periodik të procesit mësimor. GVJ konstatoi si pjesë të DVV, dokumentacionin për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor, performancën e stafit akademik, programeve të studimit të ofruara nga UNIKO, etj. Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua përfshirja e studentëve për vlerësimin e zhvillimit të procesit të mësimdhënies. Në përfundim të çdo semestri (2 (dy) here në vit, NjSBC, organizon plotësimin e pyetësorit me studentët, përmes të cilëve studentët vlerësojnë format e mësimdhënies, përmbajtjen e lëndës, si edhe performancën e stafit akademik. Referuar të dhënave të RVB, cilësia e mësimdhënies vlerësohet periodikisht dhe është objekt i përmirësimit të vazhdueshëm bazuar në vlerësimin e performancës së stafit akademik. Vlerësimi i performancës së stafit akademik përfshin: vlerësimin e performancës së stafit akademik, bazuar në standardet dhe kriteret e përcaktuara për veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe vlerësimin nga studentët të performancës së stafit akademik. FE si njësi kryesore dhe DFK si njësi bazë, në mënyrë të vazhdueshme ka përmirësuar, metodat e mësimdhënies duke reflektuar, mendimet dhe sugjerimet e studentëve në këtë proces.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, institucioni ka miratuar ngritjen e strukturave përkatëse në funksion të garantimit të cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre. Në nivel institucional, strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë është: Sektori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alumni (SKVIA), brenda Drejtorisë Kurrikulës Vlerësimi Institucional (DKVI). Në nivel fakulteti, strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Cilësisë janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), Grupi i Vlerësimi të Brendshëm, Koordinatorët e programeve të studimeve, Qendra e Karrierës dhe Alumni dhe Sekretaria Mësimore. Referuar të dhënave të RVB, Sektori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alumni dhe Qendra e Mësimdhënies dhe Këshillimit pranë UNIKO, ka mbështetur stafin akademik, nëpërmjet trajnimeve të veçanta që kanë në fokus përmirësimin e aftësive dhe përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies. Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua se kjo zyrë në veprimtarinë e saj ka si qëllim, vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, cilësisë së

	mësimdhënies, rezultateve të punës kërkimore dhe shkencore si dhe performancën e personelit akademik dhe ndihmës akademik. NJSBC, çdo vit për veprimtarinë e saj përgatit raportin vjetor, një kopje të të cilit ia përcjell njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Gjatë vizitës në institucion u konfirma se, këto struktura mbështesin zhvillimet inovatore të procesit mësimor, vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin e performancës së stafit akademik, si dhe veprimtarive të tjera administrative të personelit akademik dhe ndihmës akademik në nivel institucional. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 1.16_Manuali i Cilesise_UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 2.18_Model i formularit te vleresimit te performances se stafit akademik_UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 2.19_Model i formularit te vleresimit nga studentet per stafin akademik_UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 2.21_Urdher i rektorit Nr.557, date 09.09.2024, Per Krijimin e qendres se mesimdhënies dhe keshillimit_UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 3.7_Raportet vjetore te NJSBC-se_UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.8_Lista e NJSBC-se_UNIKO dhe vendimi nr.642, date 16.09.2024, Per ndryshimin e anetareve te NJSBC ne nivel universiteti;</i> <i>Dok_Aneks 3.8-a_Lista e NJSBC-se_Fakulteti Ekonomik dhe vendimi nr.596, date 16.09.2024, Per ndryshimin e anetareve te NJSBC ne nivel fakulteti;</i> <i>Dok_Aneks 3.13_Pyetesor studentor fund kursi_UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 3.28_Raport i analizes se te dhenave te pyetesorit studentor per cilesine e mesimdhënies per programet e studimit ne FE.</i> https://unkorce.edu.al/26223-2/; https://unkorce.edu.al/studentet-qendra-e-karrieres-dhe-alumni/.			
Konkluzione	<i>Referuar rregullores së Programit të Studimit MP në “Bankë dhe Sigurime” si dhe programet e lëndëve, format e mësimdhënies në këtë program studimi përfshijnë, (leksione, seminare, ushtrime, projekte/detyra kursi, etj).</i> <i>Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik u konfirmua, zhvillimi i mësimin në mënyrë interaktive me studentët gjatë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, punës individuale dhe në grup.</i> <i>Pranë UNIKO, janë ngritur dhe funksionojnë strukturat përkatëse me qëllim përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së mësimdhënies dhe performancës të stafit akademik dhe ndihmës akademik. GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregulloret institucionale dhe Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në Bankë dhe Sigurime (neni, 13), parashikon format e mësimdhënies dhe detyrimet e studentit ndaj lëndës. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike dhe përfshin (leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, praktikën profesionale dhe temën e diplomës). Rregullorja e njësisë bazë (DFK), e programit të studimit si dhe syllabuset e secilës lëndë, parashikojnë me detaje, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe dijeve të studentëve. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përfshijnë; (provimin e ndërmjetëm, aktivizimi në seminare, ese, projekte/detyra kursi (30%) të vlerësimit dhe provimi përfundimtar 70%). Sipas rregullores së programit të studimit studenti është i detyruar të frekuentojë orët mësimore në masën 75%. Për programin e studimit MP_B&S, referuar planit mësimor, parashikohet që në semestrin e dytë, të kryhet praktika profesionale dhe përgatitja e temës diplomës. Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive bëhen publike në faqen e web-it të UNIKO.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar të dhënave për programet e lëndës, GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, si: titulli i lëndës, titullari, ngarkesa në orë dhe kredite, tipologjia e lëndës (kategoria), viti dhe semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, programi i studimit të cilit i përket, temat e lëndës, literaturën bazë dhe mbështetëse, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të lëndës. Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konfirmua se, studentët informohen nga pedagogu i lëndës/modulit përkatës në javën e parë të mësimit, për të gjithë elementët, përmbajtjen e lëndës, objektivat formues, instrumentat e vlerësimit, format e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit. Programet lëndore vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit, nëpërmjet mënyrave të brendshme të komunikimit mes studentëve dhe pedagogëve të programit të studimit. Gjithashtu informimi i studentëve lidhur me format e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve bëhet nëpërmjet sistemit "Pitagora", ku çdo student merr informacion online përmes llogarisë së vet. Komponentët formues të programit në përgjithësi, janë konform formateve të kërkuara sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021.

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Format dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve, përcaktohen në Rregulloren e njësisë bazë dhe Rregulloren e Programit të Studimit MP në Bankë dhe Sigurime. Këto forma dhe kritere vlerësimi, përfshijnë; a) vlerësimin e vazhduar (30%) që përfshin (provimin e ndërmjetëm, pjesëmarrja dhe aktivizimin në seminare, esse, projekte/detyra kursi), b) provimi përfundimtar (70%). Nota përfundimtare e studentit është totali i elementëve të mësipërm. GVJ gjykon se përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin dhe demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor që zhvillohet lënda/moduli përkatës. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.8_Programet Lendore te Programit te Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime.</i> <i>Dok_Aneks 1.6_Marreveshja me RASH per sistemin elektronik Pitagora_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.6.1_Manuali per sistemin elektronik Pitagora_UNIKO.</i>			
Konkluzione	Format dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive dhe dijeve përfshijnë; provimin e ndërmjetëm, pjesëmarrja, aktivizimi gjatë seminareve, esetë, detyrat/projektet e kursit, dhe provimin përfundimtar. Nga takimi me stafin akademik u konfirmua se studentët, informohen nga pedagogu i lëndës në javën e parë të fillimit të mësimit, për elementët, përmbajtjen e lëndës, si edhe metodologjitë e vlerësimit. GVJ, shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në	GVJ konstatoi se, sipas Rregullores së Programit të Studimit MP në Bankë dhe Sigurime, vlerësimi i njohurive dhe dijeve të studentit, mbështetet në elementët e kontrollit të vazhdueshëm (provimi i ndërmjetëm, pjesëmarrja, aktivizimi dhe diskutimi në seminare, punë individuale dhe në grup;

vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	detyra/projekte kursi, esse, etj.) dhe provimin përfundimtar. Nota përfundimtare e studentit është totali i elementëve të mësipërm. Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues (<i>Syllabysset e lëndëve</i>), si dhe gjatë takimit të GVJ me stafin akademik u konfirmua se, studentët informohen nga pedagogu i lëndës/modulit përkatës, për elementët, përmbajtjen e lëndës, si edhe metodologjinë e vlerësimit të njohurive dhe kontrollit të dijeve. GVJ gjykon se këto forma dhe mënyra vlerësimi, i motivojnë studentët të përgatiten gjatë gjithë semestrit që zhvillohet programi i lëndës/modulit përkatës. GVJ, konfirmon përmbushjen e plotë të këtij kriteri.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatoi se UNIKO në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), ka nënshkruar një marreveshje për aplikimin e projektit "Clean Score", lidhur me korigjimin dhe vlerësimin e provimeve të studentëve në mënyrë elektronike. Në Fakultetin e Ekonomisë, përfshirë edhe modulet e programit të studimit Master Profesional "Bankë dhe Sigurime" është implementuar, vlerësimi elektronik i testimeve dhe provimeve përmes sistemit "CleanScore", krahas vlerësimit që aplikohet nëpërmjet platformave online Google Classroom, Office 365 for Education, etj, të mundësuar nga shërbimet online të UNIKO, të cilat janë të aksesueshme nga pedagogët dhe studentët. Këto mënyra korigjimi dhe vlerësimi të testimeve dhe provimeve u konfirmuan dhe gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Mënyra e vlerësimit të studentëve në programin e studimit MP_B&S është analizuar nga GVJ në kriteret më lart dhe gjendet e përfshirë në mënyrë transparente në rregulloren e programit të studimit si edhe në programet lëndore/syllabuset përkatëse. Vlerësimi me notë bëhet mbështetur në totalin e pikëve të vlerësimit gjatë vitit/vazhduar dhe pikët e provimit përfundimtar (Rregullorja e FE, DFK dhe programit të studimit). Në të gjitha format e provimit përdoret, sistemi i vlerësimit me 100 pikë, të cilat konvertohen në notë. Gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konfirmua se vlerësimi përfundimtar i lëndës ndjek formën dhe mënyrën e parashikuar në rregullore dhe syllabuset/programet e lëndëve dhe nuk ka shmangie nga ky rregull vlerësimi. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.8_Programet Lendore te Programit te Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime.</i> <i>Dok_Aneks 1.6_Marreveshja me RASH per sistemin elektronik Pitagora_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.6.1_Manuali per sistemin elektronik Pitagora_UNIKO;</i>

	<i>Dok_Aneks 2.24_Model procesverbali i gjeneruar nga sistemi Pitagora;</i> <i>Dok_Aneks 3.32_Korrigjimi i automatizuar i provimeve AADF_UNIKO.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues në DVV (Rregullores së UNIKO-së, Rregulloreve të njësishë kryesore/bazë dhe Rregullores së Programit të Studimit), dhe sipas RVB për këtë kriter, studenti pasi njihet me rezultatet e provimit ka të drejtë të paraqitet para komisionit të provimit për t'u sqaruar apo diskutuar lidhur me rezultatet e tij në provim. Gjatë kësaj procedure studentit i paraqitet teza e provimit e zgjidhur, në rastet kur përgjigjia e dhënë prej tij nuk është e saktë, në mënyrë që të informohet për përgjigjen korrekte. Pasi u komunikon studentëve, vlerësimin dhe rezultatet e provimit, pedagogu i pasqyron, ato në sistem brenda afateve të përcaktuara. Pedagogu i lëndës dorëzon pranë sekretarisë mësimore, procesverbalin e rezultateve si dhe tezat e provimit të korrigjuara brenda afateve të përcaktuara. Kjo praktikë u konfirmua nga GVJ gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në (Rregulloren e UNIKO-së, Rregulloreve të njësishë kryesore/bazë, si dhe Kodin e Etikës të UNIKO-së), GVJ konstaton se janë parashikuar procedura specifike në lidhje me zhvillimin e provimeve, dhe disa nga këto rregulla janë në funksion të shmangies së plagjiaturës dhe kopjimit. Gjatë zhvillimit të provimit, komisioni monitoron studentët për të shmangur kopjimet apo mashtrimet me mjete jo të lejueshme. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme përjashtohet nga provimi. Gjatë takimeve me P/Dep dhe stafin akademik, u konfirmua se për plagjiaturën dhe kopjimin në provime, ndaj studentëve merren masa si përjashtimi i tyre nga provimi. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 1.19_Kodi i Etikës_UNIKO_2022.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në Rregulloren e institucionit, Rregulloreve të njësishë kryesore/bazë, rezultati i provimit i komunikohet studentëve brenda afateve të parashikuara, brenda 6 ditëve nga data e kryerjes së provimit. Pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretari dhe në Sektorin e TIK-ut, pasqyrën e rezultateve të provimit jo më vonë se 8 ditë nga data e zhvillimit të provimit. Komunikimi i rezultatit të provimit bëhet individualisht online për çdo student në llogarinë e tyre, përmes sistemit Pitagora ose nga sekretaria mësimore. Pedagogu i lëndës dorëzon pranë sekretarisë mësimore, procesverbalin e rezultateve brenda afateve të përcaktuara me nënshkrimet përkatëse. Kjo u konfirmua dhe gjatë vizitës së GVJ në sekretarinë mësimore.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur	Nga shqyrtimi i Rregullores së institucionit, Rregulloreve të njësishë kryesore/bazë dhe Rregullores së Programit të Studimit, GVJ konstatoi se,

me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	institucioni garanton të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët informohen mbi rezultatet e provimit në librezën e tyre elektronike, por nëse nuk e kanë marrë këtë informacion për arsye të ndryshme, mund të informohen pranë sekretarisë mësimore. Çdo student ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimet me shkrim nga data e zhvillimit së tij dhe i drejtohet Drejtuesit të Njesisë Kryesore.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Referuar rregullores së institucionit, rregulloreve të njesisë kryesore/bazë dhe RVB-së, çdo ankesë shqyrtohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore, i cili thërret për sqarime përgjegjësin e departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës brenda dy ditëve. Kur ankesa është e drejtë, Drejtuesi i Njesisë Kryesore, e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, që studenti të ri japë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë së bashku me dokumentacionin përkatës administrohet nga njësia kryesore dhe njësia bazë. Kjo praktikë u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.8_Programet Lendore te Programit te Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime.</i> <i>Dok_Aneks 1.6_Marreveshja me RASH per sistemin elektronik Pitagora_2022;</i> <i>Dok_Aneks 2.24_Model procesverbali i gjeneruar nga sistemi Pitagora.</i>
Konkluzione	Bazuar në rregulloret institucionale dhe rregulloren e programit të studimit, institucioni garanton të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit. GVJ konstatoi se UNIKO në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) ka nënshkruar një marrëveshje, lidhur me korigjimin dhe vlerësimin e provimeve të studentëve në mënyrë elektronike. GVJ, gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, synon të pajisë studentët me njohuri të avancuara teorike dhe koncepte praktike, me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale si dhe të përgatisë specialistë të aftë, që t’u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të tregut të punës në fushat e shërbimeve financiare, sektorit bankar, sigurimeve dhe kontabilitetit. Nga shqyrtimi dhe analiza e Kurrikulës dhe Planit mësimor të këtij programi studimi, lëndëve të përfshira, garantohej thellimi i njohurive dhe zhvillimi i aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve në fushat përkatëse. Gjithashtu, një komponent i rëndësishëm është dhe kryerja e praktikës profesionale si dhe përgatitja e temës diplomës duke i dhënë mundësi, studentëve për tu thelluar në njohuritë praktike dhe profesionale në përputhje me objektivat e programit të studimit.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Nga shqyrtimi i Kurrikulës dhe Planit Mësimor, GVJ konstatoi se ka disa lëndë të cilat fokusohen në trajtimin e elementëve që lidhen me teknologjinë e informacionit, shkencat humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë të informacionit nëpërmjet lëndëve si: “Seminar Special mbi Bursat dhe Platformat Online”, “Parashikimi dhe Vlerësimi financiar”, “Ekonometri”. Plani mësimor i programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Bankë dhe Sigurime dhe programet e lëndëve, mundësojnë pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si dhe aftësi profesionale në fushat e shërbimeve financiare, sektorit bankar, sigurimeve dhe kontabilitetit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Referuar të dhënave për programet e lëndës, GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara si përmbajtjen e lëndës, objektivat formues, instrumentat e vlerësimit, format e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit. Çdo lëndë ka objektivat dhe specifikat e saj në lidhje me kompetencat që duhet të arrijnë studentët në përfundim të lëndës së zhvilluar. Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik, u konfirmua se në përputhje me rregulloren dhe objektivat e programit të studimit, në javën e fundit të semestrit, pedagogu i lëndës bën një përmbledhje të njohurive dhe aftësive që janë arritur nga ana e studentëve, si dhe orienton ata në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku duhet të përqëndrohen, në provimin përfundimtar. Udhëzuesi i Temës së Diplomës përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen e temës/mikrotezës.

	Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.8_Programet Lendore te Programit te Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.31_Udhezuesi i diplomes MP ne Banke dhe Sigurime.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Për programin e studimit MP në "Bankë dhe Sigurime", referuar planit mësimor, parashikohet që në semestrin e dytë të kryhet praktika profesionale dhe përgatitja e temës diplomës. Nëpërmjet bashkëpunimeve institucionale, mundësohen praktikatat profesionale për një përshtatje sa më të shpejt me tregun e punës dhe për të siguruar njohuri plotësuese dhe kompetenca profesionale për studentët. Stafi akademik nxit dhe mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve gjatë trajtimit të rasteve studimore, eseve dhe përgatitjen e detyrave të kursit me qëllim aftësimin për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të caktuara. Gjatë takimit me studentët, ata u shprehën pozitivisht për mbështetjen që kanë pasur në këtë drejtim nga stafi akademik dhe institucioni. GVJ konfirmon përbushjen e plotë të këtij kriteri.
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik, realizon zhvillimin e leksioneve të hapura dhe seminare mbi çështje të rëndësishme bashkëkohore të fushës së studimit, që demonstrojnë ndërthurjen e mësimdhënies nga stafi akademik me përfaqësues të institucioneve partnere për të mundësuar prezantimin e ideve mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë lidhur me programin e studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si dhe nga takimi i GVJ me stafin akademik u konfirmua se njësia kryesore dhe njësia bazë, kanë organizuar në mënyrë periodike aktivitete konsultative, tryeza të rumbullakta, workshope, leksione të hapura me përfaqësues të institucioneve publike, bizneseve private, specialistë dhe ekspertë të fushës, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës dhe ofrimin e ekspertizës në funksion të objektivave të programit të studimit.
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Referuar dokumentacionit në DVV, institucioni angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për të mbështetur dhe inkurajuar idetë inovatore të studentëve. Kontributi financiar i institucionit ka qenë në drejtim të organizimit të konferencave shkencore studentore si dhe pjesëmarrjes në projekt kërkimore-shkencore.

	Referuar analizës së RVB, dhe gjatë vizitës në institucion u konfirmua se, stafi akademik nxit dhe motivon studentët të angazhohen në projekte kërkimore duke u bërë pjesë e tyre. Studentët e këtij programi studimi me nxitjen dhe mbështetjen e pedagogëve të departamentit kanë marrë pjesë në konferencat shkencore të organizuara nga UNIKO dhe universitete të tjera. Gjatë takimeve të GVJ, me studentët e këtij programi studimi u konfirmua përfshirja e tyre, në projekte, aktivitete kërkimore, konferenca shkencore, etj. UNIKO mbështet financiarisht pjesëmarrjen e studentëve në projekte dhe konferenca shkencore si dhe ofron në dispozicion mjediset e veta për realizimin e tyre. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.1_Lista e projekteve te zbatuara nga FE_UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 2.20_Analiza vjetore e veprimtarise mesimore, kerkimore-shkencore e nderkombetarizimit te UNIKO_2022-2023;</i> <i>Dok_Aneks 3.9_Analiza vjetore e veprimtarise mesimore per vitin akademik per FE_2022-2023;</i> <i>Dok_Aneks 4.11_Veprimtari te organizuara nga Dep. Finance-Kontabilitet;</i> <i>Dok_Aneks 4.14_Tabelat permbledhese per programin e studimit MP Banke dhe Sigurime.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit MP në “Bankë dhe Sigurime”, garanton pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara profesionale në fushat e shërbimeve financiare, sektorit bankar, sigurimeve dhe kontabilitetit.</i> <i>GVJ konstatoi se institucioni, në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat partnere me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi, organizon takime, workshope dhe leksione të hapura, në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit. GVJ konfirmon, shkallën e përmbushjes së plotë të këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues në DVV (Rregullore të UNIKO-së, Rregulloretë të njësisë kryesore/bazë, neni, 56, 26 Rregullore të Programit të Studimit, neni 15), detyrimi përmbyllës finalizohet me përgatitjen e temës diplomës. Diplomimi në përfundim të ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, realizohet me temë diplome. Departamenti dhe Fakulteti vendos në dispozicion të studentëve udhëzimin për përgatitjen e temës diplomës në përputhje me rregulloren e programit të studimit. Departamenti përcakton listën e temave të diplomave në përputhje me fushat e studimit që mbulon.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Referuar RVB, drejtuesi i njësisë bazë dhe stafi akademik udhëzojnë studentët duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të përgatitjes së temës diplomës. Sipas Rregullores së Programit të studimit, njësia bazë përcakton listën e temave të diplomave dhe të personelit akademik për udhëheqjen e studentëve në përgatitjen e temës. Në mbështetje të studentit në këtë proces janë gjithashtu dhe Zyra e informimit dhe orientimit të studentit në FE, e cila vë në dispozicion të studentëve Udhëzuesin për përgatitjen e temës diplomës, Sekretaria e departamentit, e cila afishon në stendat informuese në mjediset e FE, informacionet që lidhen me procesin (pedagogët udhëheqës, afatin e dorëzimit të punimit, etj). Udhëzimin për përgatitjen e temës diplomës në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit, përcakton të gjitha modalitetet e nevojshme, rregullat dhe kriteret për përgatitjen e punimit të diplomës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Sipas Rregullores së Programit të Studimit (neni 15), citohet se Diplomimi në përfundim të ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, realizohet me temë diplome. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.31_Udhezuesi i diplomes MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.31-a_Lista e temave te diplomave te miratuara nga Departamenti Finance-Kontabilitet.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit	Referuar dokumentacionit shoqërues në DVV, në rregulloren e programit të studimit dhe udhëzimit për përgatitjen e diplomës, përcaktohet se pedagogu udhëheqës asiston studentët në procesin e përgatitjes së punimit të diplomës duke përcaktuar grafikun e konsultimeve përgjatë të cilave kontrollon dhe vlerësohet, ecuria e përgatitjes së punimit dhe i udhëzon ata për elementët e nevojshëm (rregullat e shkrimit, strukturën e punimit, rishikimit të

përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	literaturës, metodologjisë, rezultateve dhe diskutimeve, konkluzionet, referencat si dhe anekset përkatëse). Para mbrojtjes së diplomës, pedagogu udhëheqës rishikon punimin e kryer nga studenti dhe miraton mbrojtjen e temës diplomës duke plotësuar formularin përkatës të vlerësimit të studentit. Kjo procedurë, u konfirmua edhe nga takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë përgatitjes të punimit të diplomës, studenti mund të shfrytëzojë bibliotekën e fakultetit, bibliotekën online, si dhe laboratorët e informatikës. Gjatë vizitës në institucion, studentët, u shprehën pozitivisht për mbështetjen institucionale, nëpërmjet shfrytëzimit të mjediseve të institucionit, si dhe asistencës nga stafi akademik gjatë gjithë procesit të përgatitjes së temës diplomës.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Referuar, Rregullores të njësisë kryesore/bazë dhe Rregullores së Programit të Studimit, mbrojtja e diplomës bëhet përpara një komisioni, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti përkatës dhe miratohet nga Dekani. Studenti prezanton punimin e diplomës para Komisionit të Diplomimit. Në përfundim të mbrojtjes së temës së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Në vlerësimin e temës diplomës, merret parasysh vlerësimi i udhëheqësit të temës, i oponentit dhe komisionit, të cilët gjykojnë dobinë e punimit dhe zbatimin praktik të tij; cilësinë e prezantimit; përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve; si dhe arritjet akademike të studentit, gjatë ciklit të studimit.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Rregulloret e njësisë kryesore/bazë si edhe Rregullorja e Programit të Studimit, përcaktojnë se studenti pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet përkatëse, pajiset me diplomë Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime". Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin e diplomës, sipas modelit të miratuar nga MAS. Sipas kërkesës së tyre, studentëve i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e dokumentacionit e nënshkruar nga Dekani i Fakultetit dhe drejtuesi i njësisë bazë, për programin e studimit që kanë kryer.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në rregulloren përkatëse si dhe në zbatim të kriterëve dhe udhëzimeve të MAS, diploma për programin e studimit, Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime", është regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore të MAS. Sekretaria dokumenton tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës për secilin student, që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike. Dokumentacioni në hard copy, ruhet dhe administrohet nga sekretaria mësimore e fakultetit dhe në formë elektronike në sistemin Pitagora. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2_Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3_Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i>

	<i>Dok_Aneks 2.7_Plani Mesimor i Programit te Studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit te studimit MP ne Banke dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 2.6_Modeli i Diplomes dhe Supplementit të diplomës në Programin e Studimit MP ne Banke dhe Sigurime.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ nga shqyrtimi i rregulloreve përkatëse konstaton se, janë përshkruar dhe përcaktuar në mënyrë të detajuar, procedurat që ndiqen për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit.</i> <i>Diplomimi për programin e studimeve, MP në “Bankë dhe Sigurime”, bëhet me temë diplome. Në përfundimin me sukses të studimeve, studenti pajiset nga fakulteti me diplomën, Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, listën e notave dhe suplementin e diplomës.</i> <i>Dokumentacioni përkatës, ruhet dhe administrohet në hard copy dhe në formë elektronike. GVJ konfirmon, shkallën e përmbushjes së plotë të këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Referuar dokumentacionit shoqërues të DVV, konstatohet se në kurrikulën dhe planin mësimor të programit të studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”, përfshihet dhe praktika profesionale si lëndë e kategorisë D, e cila vlerësohet me 2 kredite dhe realizohet në semestrin e dytë, të vitit të parë të studimeve. Praktika profesionale zhvillohet për një periudhë dy javore. Sipas rregullores së njësisë kryesore dhe njësisë bazë, si dhe planit mësimor të programit të studimit, kohëzgjatja dhe afati i kryerjes përcaktohen në strukturën e vitit akademik dhe udhëzuesin e praktikës profesionale. Në përputhje me fushën e programit të studimit, institucioni dhe departamenti u ofron studentëve listën e institucioneve, kompanive dhe organizatave partnere me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikës profesionale. Praktikat profesionale kryhen në institucione dhe kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit	Referuar dokumentacionit shoqërues, GVJ konstaton se, me qëllim plotësimin e objektivave të programit mësimor, UNIKO dhe FE ka një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucioneve publike, sipërmarrje dhe biznese private, institucione financiare dhe banka, kompani sigurimi, të cilat

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	mundësojnë kryerjen e praktikës profesionale për studentët e këtij programi studimi. Këto marrëveshje bashkëpunimi përveç aspekteve të tjera, garantojnë dhe u ofrojnë mundësi studentëve që të zhvillojnë praktikën profesionale me qëllim pajisjen e tyre me aftësi praktike dhe kompetenca profesionale, në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe kërkesat e tregut të punës. Gjatë takimit të GVJ me studentët, ata u shprehën pozitivisht për mbështetjen që kanë pasur nga stafi akademik dhe institucioni, për kryerjen e praktikës profesionale.
Kriteri 3. Praktikën profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Në rregulloret e njësive kryesore/njësive bazë, dhe udhëzimit për kryerjen e praktikës profesionale, është përcaktuar në mënyrë të detajuar, organizimi, zhvillimi dhe mbrojtja e praktikës profesionale për për studentët e këtij program studimi. Studenti pas përfundimit të praktikës profesionale, bën mbrojtjen përpara komisionit përkatës, duke prezantuar raportin/relacionin për praktikën e kryer. Vlerësimi bëhet, bazuar në njohuritë dhe aftësitë që studentët kanë përfituar gjatë kryerjes së praktikës, duke marrë në konsideratë vlerësimin nga institucioni/kompania ku ka kryer praktikën si dhe vlerësimin nga pedagogu udhëheqës/mbikqyrës. Vlerësimi i praktikës profesionale bëhet me notë. <i>GVJ rekomandon, rishikimin e strukturës dhe planit mësimor të programit të studimit, sa i përket kohëzgjatjes së zhvillimit të praktikës profesionale, në mënyrë që studentët të fitojnë njohuri dhe kompetenca të plota profesionale, dhe të përshtaten sa më shpejt me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 _Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Dok_Aneks 1.2 _Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.2 _Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.3 _Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Dok_Aneks 2.5 _Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023;</i> <i>Dok_Aneks 2.7 _Plani Mësimor i Programit të Studimit MP në Bankë dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.27_Kurrikula e programit të studimit MP në Bankë dhe Sigurime;</i> <i>Dok_Aneks 3.5_Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;</i> <i>Dok_Aneks 2.13_Udhëzuesi për praktikën profesionale në programin e Studimit MP në Bankë dhe Sigurime_FE_UNIKO.</i>
Konkluzione	<i>Kurrikula dhe plani mësimor i programit të studimit MP në "Bankë dhe Sigurime", përfshin dhe praktikën profesionale si lëndë e kategorisë D, e cila realizohet në semestrin e dytë, të vitit të parë të studimeve.</i> <i>Praktika profesionale nga studentët e këtij programi studimi, zhvillohet pranë institucioneve dhe organizatave partnere me të cilat, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.</i>

	Në Rregulloret e njësive kryesore/njësive bazë, dhe udhëzimit përkatës, është përcaktuar në mënyrë të detajuar, organizimi, zhvillimi dhe mbrojtja e praktikës profesionale për studentët e këtij program studimi. GVJ konfirmon, se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi – konkretisht nenet 57, 59 dhe 66 të Ligjit nr. 80/2015, nenet 41 dhe 48 të Statutit të Universitetit të Korçës, si dhe nenet 27 dhe 36 të Rregullores së UNIKO-s – dhe duke iu referuar RVB-së, Fakulteti Ekonomik garanton se stafi akademik i angazhuar mbulon lëndët dhe modulet në nivel profesional, duke disponuar përvojë akademike disaveje në përputhje me natyrën e programit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime”. GVJ vëren se, ndonëse stafi akademik ka publikuar artikuj shkencorë në revista të indeksuara, rekomandohet që të intensifikohet angazhimi në botimin e artikujve në revista me faktor impakti. Gjithashtu, këshillohet që të zgjerohet edhe përvoja praktike e stafit, duke shfrytëzuar më mirë potencialin që ofron rajoni i Korçës. Referenca: Ligj Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022 Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023 Dok_Aneks 2.9_Jetëshkrimet (CV) e Stafit Akademik ne Programin e Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime Dok_Aneks 2.26_Të dhëna të përgjithshme për personelin akademik të Departamentit Financë-Kontabilitet – Personeli i angazhuar në programin “Bankë dhe Sigurime” Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023

	https://unkorce.edu.al/departamenti-i-finance-kontabilitet/ Dok_Aneks 4.4_Tabela e të dhënave për kualifikimin dhe kërkimin shkencor për personelin akademik të Departamentit Financë-Kontabilitet
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Ky program ofrohet nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, në kuadër të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Korçës, dhe është plotësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të këtij fakulteti, i cili mban përgjegjësinë për zbatimin e tij. Departamenti është i organizuar në përputhje me kërkesat e nenit 25, pika 4, të Ligjit nr. 80/2015. Në përbërje të këtij departamenti janë gjithsej 13 staf akademik (PAE), nga të cilët 92% mbajnë tituj akademikë ose grada shkencore. Konkretisht, stafi përbëhet nga 5 profesorë të asociuar, 7 doktorë shkencash dhe 1 kandidat në proces doktorature. Për realizimin e lëndëve të programit të studimit MP në "Bankë dhe Sigurime" janë angazhuar staf akademik si në vijim: 5 profesorë të asociuar dhe 8 doktorë shkencash. Referenca: Ligj Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022 Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023 Dok_Aneks 2.9_Jetëshkrimet (CV) e Stafit Akademik në Programin e Studimit MP në Bankë dhe Sigurime Dok_Aneks 2.26_Të dhëna të përgjithshme për personelin akademik të Departamentit Financë-Kontabilitet – Personeli i angazhuar në programin "Bankë dhe Sigurime" Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023 Dok_Aneks 4.14_Tabelat përmbledhese për programin e studimit MP_Banke dhe Sigurime Dok_Aneks 4.4_Tabela e të dhënave për kualifikimin dhe kërkimin shkencor për personelin akademik të Departamentit Financë-Kontabilitet
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Stafi akademik i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, përveç angazhimit në programin e studimit MSc në "Financë", kontribuon gjithashtu në realizimin e disa programeve të tjera të ofruara nga UNIKO. Në përputhje me nenet 57 pika 2 dhe 59 të Ligjit nr. 80/2015, si dhe me përcaktimet e VKM nr. 329, datë 12.04.2017 dhe nenet 39 dhe 41 të Statutit të UNIKO, nuk janë evidentuar shkelje të kuadrit ligjor përkatës gjatë kontrollit të ushtruar në institucion, përfshirë shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik. Duke qenë se ky program zhvillohet në një universitet shtetëror, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vëren se ekziston qëndrueshmëri në trupën akademike të angazhuar përgjatë gjithë periudhës së akreditimit, si në aspektin e marrëdhënieve të punës me kontrata të pacaktuara, ashtu edhe në përmbushjen e detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimin në burim mbi të ardhurat nga punësimi. Të gjitha këto aspekte janë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjit nr. 10 383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm

	të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; si dhe me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.9_Jetëshkrimet (CV) e Stafit Akademik ne Programin e Studimit MP ne Bankë dhe Sigurime</i> <i>Dok_Aneks 2.26_Të dhëna të përgjithshme për personelin akademik të Departamentit Financë-Kontabilitet – Personeli i angazhuar në programin “Bankë dhe Sigurime”</i> https://unkorce.edu.al/departamenti-i-finance-kontabilitet/ <i>Dok_Aneks 4.2 Tabela përmbledhëse e ngarkesave të realizuara të personelit efektiv në nivel fakulteti në fund të çdo viti;</i> <i>Dok_Aneks 1.4 Rregullorja e Drejtorise Juridike dhe Burimeve Njerezore;</i> <i>Dok_Aneks 3.29 Model i kontratës individuale të punës</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Në përputhje me nenin 59, pika 8 të Ligjit nr. 80/2015, Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe nenin 31 të Rregullores për veprimtarinë mësimore të UNIKO-s, institucioni respekton detyrimet ligjore për të siguruar që personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” të jetë në përputhje me nivelin e kërkuar të kualifikimit dhe të përmbushë kriteret lidhur me ngarkesën mësimore. Këto elementë janë të reflektuara qartë edhe në syllabuset e lëndëve përkatëse të programit. Referenca: <i>Ligj Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”</i> <i>Dok_Aneks 1.1_Statuti i UNIKO_2022</i> <i>Dok_Aneks 1.2_Rregullore e UNIKO_2023</i> <i>Dok_Aneks 2.26_Të dhëna të përgjithshme për personelin akademik të Departamentit Financë-Kontabilitet – Personeli i angazhuar në programin “Bankë dhe Sigurime”</i> <i>Dok_Aneks 2.5_Rregullore e PS_MP_Banke dhe Sigurime_2023</i> <i>Dok_Aneks 4.4 Kualifikimi dhe kerkimi shkencor të dhëna mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore të Departamentit Financë-Kontabilitet;</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<i>Ky program nuk përfshin orë laboratorike</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna	Njësia përgjegjëse për administrimin e të dhënave dhe kontratave individuale të punës për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në UNIKO është Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerezore. Kjo drejtori është e ngarkuar me ruajtjen e kopjeve të kontratave individuale

përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	të punës si dhe me monitorimin e afateve përkatëse të tyre, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Rregulloren e UNIKO për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, si dhe Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e kësaj Drejtorie, përkatësisht nenin 4, pika d dhe nenin 7, pika 8. Baza e të dhënave të administruara përfshin: dosjen personale të stafit akademik, organikën e Fakultetit Ekonomik, jetëshkrimet (CV-të) e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, marrëveshjet për organizimin e kohës vjetore, formularët e ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditorit, syllabuset, regjistrat e pedagogëve, si dhe dokumentacion tjetër të parashikuar në Kreun I, pika 3 të udhëzimit përkatës. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 – Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", miratuar me Urdhrin nr. 22, datë 24.01.2022, të MAS;</i> <i>Dok_Aneks 1.1 – Statuti i UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 1.2 – Rregullorja e UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 1.4 – Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore;</i> <i>Dok_Aneks 1.9 – Rregullorja për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale;</i> <i>Dok_Aneks 1.13 – Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik;</i> <i>Dok_Aneks 1.14 – Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit akademik;</i> <i>Dok_Aneks 2.9 – Jetëshkrimet e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit;</i> <i>Dok_Aneks 2.12 – Modeli i programit lëndor (syllabusi);</i> <i>Dok_Aneks 2.25 – Organika e Fakultetit të Ekonomisë;</i> <i>Dok_Aneks 2.33 – Model dokumenti për organizimin e kohës vjetore të punës;</i> <i>Dok_Aneks 3.15 – Kriteret, procedurat e shpalljes dhe ngritjes së komisionit të rekrutimit të stafit;</i> <i>Dok_Aneks 3.24 – Jetëshkrimet e stafit ndihmës akademik dhe administrativ;</i> <i>Dok_Aneks 3.32 – Formulari i ngarkesës së orëve mësimore;</i> <i>Dok_Aneks 4.9 – Format i regjistrat të pedagogut;</i> <i>Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 – "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;</i> <i>Dok_Aneks 2.26 – Të dhëna të përgjithshme për personelin akademik të Departamentit Financë-Kontabilitet – Personeli i angazhuar në programin "Bankë dhe Sigurime".</i> <i>Link : 5.10 Organograma e UNIKO</i> <i>https://unkorce.edu.al/?s=organograma&post_type=post;</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion	Në përputhje me RVB dhe evidencat përkatëse, UNIKO, në bashkëpunim me institucione financiare, biznese, dhe institucione publike, arrin të sigurojë personel të kualifikuar për të udhëhequr, instruktuar dhe mbikëqyrur studentët gjatë praktikës profesionale, punimit të diplomës dhe aktiviteteve të tjera të natyrës së programit të studimit. Dëshirojmë të

personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	theksojmë se numri i studentëve në këtë program studimi është i ulët dhe për pasojë nuk ka vështirësi apo mungesë kapacitetesh për t'iu përgjigjur kërkesave të tyre, në përputhje me nenin 38 të rregullores së brendshme të FE dhe nenin 20 të rregullores së Departamentit të Financë-Kontabilitetit. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.13 Udhëzuesi i praktikës MP në Bankë dhe Sigurime a b c.</i> <i>Dok_Aneks 3.5 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara mes palëve, ofrohet mundësia për studentët që të përfitojnë nga përvoja dhe njohuritë e profesionistëve, duke përmirësuar kështu përgatitjen e tyre për tregun e punës. Sipas RVB dhe përgjigjeve të marra gjatë vizitës në IAL, personeli mbikëqyrës në ambientet e praktikës profesionale, i angazhuar në kuadër të këtyre marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e raportit të praktikës dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre përmes plotësimit të Formularit të Vlerësimit të Studentit Praktikant. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.13 Udhëzuesi i praktikës MP në Bankë dhe Sigurime a b c.</i> <i>Dok_Aneks 3.5 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;</i> <i>Dok_Aneks 2.29 Komisionet e mbikqyrjes së praktikës;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, në përfundim, konkludon se për programin MP në “Bankë dhe Sigurime” ka qëndrueshmëri në personelin akademik të angazhuar gjatë gjithë periudhës së akreditimit, me kontrata pa afat të punësimit dhe shlyerjen e detyrimeve përkatëse. Gjithashtu, pavarësisht se stafi akademik ka disa artikuj të publikuar në revista shkencore të indeksuara, rekomandohet që stafi të angazhohet më shumë në publikimin e artikujve me faktor impakti, si dhe të fitojë përvojë aplikative që mund të kontribuojë për zhvillimin e rajonit të Korçës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve	Nga vizita në IAL, evidentohet qartë se UNIKO është rikonstruktuar dhe ofron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Studentët e programit MP në "Bankë dhe Sigurime" kanë akses në një infrastrukturë të plotë, që përfshin ambiente mësimore, didaktike dhe logjistike të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor, duke

mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	përmbushur standardet e kërkuara, të konfirmuara edhe nga raporti i MAS. Për zhvillimin e mësimi teorik dhe praktik, janë të disponueshme salla mësimore me hapësira të mjaftueshme (duke pasur parasysh se numri i studentëve ishte shumë i ulët në këtë program studimi për periudhën që vlerësojmë) dhe pajisje audiovizuale moderne. Referenca: <i>Dok_Aneks 3.31 Rikonstruksioni i Godinës së Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 4.5 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit;</i> <i>Dok_Aneks 1.15 Raporti i kontrollit të MASR për kapacitetet pritëse të UNIKO 2024-2025</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Ndërtesa ku zhvillohet ky program studimi si edhe ushtron veprimtarinë njësia bazë e ajo kryesore quhet “Godina e Fakultetit të Ekonomisë”. Kjo ndërtesë ka kaluar në rikonstruksion të plotë, me qëllimin e krijimit të kushteve sa më bashkëkohore për studentët, si dhe për stafin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. Nga GVJ gjatë vizitës u konstatua se sallat e leksioneve janë të pajisura me teknologji të avancuar dhe mundësojnë realizimin e mësimi duke përdorur metoda moderne të mësimdhënies. Këto pajisje mund të përdoren gjithashtu nga studentët për prezantimin e detyrave të kursit, projekteve të praktikës profesionale dhe temave të diplomës. Referenca: <i>Dok_Aneks 4.5 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit;</i> <i>GVJ vizita në institucion</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vetë natyra e këtij programi studimi, nuk kërkohen studio dhe atelie, por laboratorë për përpunimin e të dhënave. Megjithatë, nga komunikimi me studentët, nuk u evidentua se ata kishin programe të instaluar dhe se realizonin klasa studimore e aplikative me programe profesionale sipas natyrës së këtij programi studimi (si për shembull: programe kontabiliteti dhe financa të aplikuara në Shqipëri, si Financa 5, ALPHA, etj.), pavarësisht se disa programe studimi për përpunim të dhënash ishin të disponueshme. Referenca: <i>Dok_Aneks 4.5 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit;</i> <i>GVJ vizita në institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në ambientet e mësimdhënies për programin MP në “Bankë dhe Sigurime” ndodhej një laborator i teknologjisë së informacionit, si dhe një laborator tjetër i ftuar përmes një projekti kombëtar. Megjithatë, nuk u evidentua që këto laboratorë të ishin të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit. Referenca:

	<i>Dok_Aneks 4.5 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit;</i> <i>GVJ vizita në institucion</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	Për realizimin e praktikave mësimore, Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka nënshkruar marrëveshje me biznese private, institucione dhe studio kontabiliteti, ku studentët mund të shohin dhe aplikojnë njohuritë që kanë fituar në kurse dhe module të ndryshme. GVJ vlerëson se, për numrin e kufizuar të studentëve në këtë program studimi, marrëveshjet për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike janë të mjaftueshme. Referenca: <i>Dok_Aneks 3.5 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e siguruar dhe vizitën e kryer, GVJ vlerëson se mjediset mësimore dhe infrastruktura që mbështesin programin janë të përshtatshme për funksionimin normal të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Ambjentet e bibliotekës ishin të mirëmbajtura, por literatura në dispozicion për studentët ishte e pamjaftueshme dhe mungonte literatura bazë, qoftë edhe në versionin e ciklit të leksioneve në formatin fizik. Referuar RVB-së, UNIKO ofron akses në Bibliotekën Shkencore për të gjithë personelin akademik dhe studentët e fakulteteve, ku ndodhen 4071 libra dhe 1265 tituj. Ndërsa biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë (FE) kishte një fond prej 5316 librash dhe 3610 titujsh, ku librat janë të disponueshëm si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhë të huaja. Konkretisht, ka 226 libra në shqip dhe 5090 libra në gjuhë të huaja. Referenca: <i>Dok_Aneks 4.6 Raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave në UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 4.1 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të	UNIKO ka ndërmarrë masa për të rritur fondin e bibliotekës në përputhje me Urdhërin Nr.39, datë 25.01.2019, të rektorit të universitetit, si dhe përmes donacioneve të ndryshme. Këto masa janë ndërmarrë për të

literaturës me botime të viteve të fundit.	përbushur kërkesat e pedagogëve, nevojat e njësive bazë, gjendjen e bibliotekës, si dhe kërkesat e studentëve dhe të komunitetit, duke marrë parasysh gjithashtu buxhetin e miratuar për Fakultetin e Ekonomisë. Megjithatë, për programin e studimit që po vlerësojmë, gjendja e literaturës të kërkuar mbetet siç u pasqyrua edhe në përgjigjen e dhënë në kriterin 1 të standartit IV.3. Referenca: <i>Dok_Aneks 4.6 Raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave në UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 4.1 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE;</i> <i>Dok_Aneks 2.32 Urdhëri Nr.39 datë 25.01.2019 të rektorit të UNIKO, Masa për shtimin e fondit të bibliotekës</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka shërben si sallë studimi dhe është e pajisur me 4 kompjuterë, internet dhe sistem ngrohjeje, duke siguruar kushte komode për studentët për lexim dhe studim. Studentët jo vetëm që mund të huazojnë libra pa pagesë, por mund të përdorin gjithashtu ambientet për studim. Biblioteka Shkencore pranë Rektoratit është gjithashtu e hapur për përdorim nga komuniteti. Referenca: <i>Dok_Aneks 4.6 Raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave në UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 4.1 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Referuar RVB-së, UNIKO ka krijuar mundësinë për stafin akademik dhe studentët të përdorin Bibliotekën Online, si pjesë e projektit për digjitalizimin e bibliotekës, i cili është një nga objektivat e Planit Strategjik të Universitetit 2022-2027. Ky shërbim ofron mundësinë për të lexuar dhe shkarkuar tekste pa pagesë, përmes një adrese email dhe fjalëkalimi të bibliotekës online, U-Library. Aksesimi është i lehtë dhe mund të bëhet përmes faqes zyrtare të universitetit, ku të gjithë përdoruesit regjistrohen me adresën e tyre zyrtare. Ky shërbim ofron mbi 170,000 libra, 70 milion artikuj akademikë, artikuj gazetash, hartat dhe mjete audiovizive. Megjithatë, vlerësimi ynë i literaturës për programin e studimit MP në "Bankë dhe Sigurime", ka evidentuar disa mungesa në literaturën specifike të këtij programi. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 4.6 Raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave në UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 4.1 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE;</i> <i>Dok_Aneks Link 5.7 Manuali për qasjen e bibliotekës online J-Store nga Universiteti " Fan S.Noli"</i> https://unkorce.edu.al/sites/default/files/Manual_JSTOR%20UNIKO.pdf <i>GVJ vizita në institucion</i>

Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Pranë godinës së Fakultetit të Ekonomisë, salla e bibliotekës shërbente si sallë studimi dhe siguronin kushte komode për lexim dhe studim për studentët. Sipas bisedave me studentët, ata mund të huazonin librat pa pagesë dhe gjithashtu mund të përdornin ambientet për studim. Referenca: <i>Dok_Aneks 4.1 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE;</i> <i>GVJ vizita në institucion</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Referuar RVB-së, bibliotekat janë të pajisura me mjete kompjuterike e fotokopje duke përfshirë gjithsej 45 kompjuterë. Konkretisht, Biblioteka Shkencore ka 6 kompjuterë, Fakulteti i Ekonomisë 4 kompjuterë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë 11 kompjuterë, ndërsa Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane disponon 28 kompjuterë. <i>Të gjitha këto mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët si edhe komunitetin jashtë UNIKO.</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 4.6 Raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave në UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 4.1 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE;</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka pranë Fakultetit të Ekonomisë ka një orar funksionimi nga ora 8:00 deri në 16:00, nga e hëna në të premte. Përdorimi i bibliotekës është i mundur vetëm me kartela regjistrimi. Studentët dhe pedagogët kanë kartela personale, ndërsa personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe anëtarët e komunitetit mund të bëhen gjithashtu anëtarë të bibliotekës universitare. Megjithatë, GVJ këshilloi që të shqyrtohet mundësia e zgjatjes së orarit të bibliotekës edhe në oraret e pasdites, përfshirë këtu zhvillimin e mësimin në pasdite për programet master. Referenca: <i>Dok_Aneks Link 5.7 Manuali për qasjen e bibliotekës online J-Store nga Universiteti” Fan S.Noli”</i> https://unkorce.edu.al/sites/default/files/Manual_JSTOR%20UNIKO.pdf <i>Dok_Aneks 4.13 Informacion mbi bibliotekën online U-Library</i> <i>Dok_Aneks 3.6 Raporti i implementimit të projektit Clean Score dhe manuali për qasjen e bibliotekës online J-Store nga Universiteti” Fan S.Noli”</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e	GVJ, referuar RVB-së, nuk evidencoi informacion dhe evidenca të përshtashme në përgjigje të këtij kriteri. Mungesat në bibliotekë janë evidentuar, siç u përmend më sipër, për këtë program studimi në kriterin 4 të standartit IV.3 Referenca: <i>Dok_Aneks 4.6 Raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave në UNIKO;</i> <i>Dok_Aneks 4.1 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE;</i>

programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	GVJ vizita në institucion			
Konkluzione	GVJ, në përfundim, evidenton se ka mungesa të literaturës bazë, përfshirë edhe versionin e ciklit të leksioneve në formatin fizik për programin e studimit MP në "Bankë dhe Sigurime". Gjithashtu, vlerëson si praktikë pozitive të UNIKO-së hapjen e bibliotekës për përdorim nga komuniteti jashtë IAL-së, një praktikë që mund të përqafohet edhe nga institucione të tjera të arsimit të lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB-së, evidentohet se UNIKO ka në dispozicion sisteme të integruara informacioni, të cilat funksionojnë si pjesë e projektit RASH. Ky sistem është një menaxhim gjithëpërfshirës i informacionit, duke mundësuar mbledhjen e të dhënave për menaxhimin e mësimdhënies, studentëve, kërkimit, burimeve njerëzore, etj. <i>Referenca:</i> <i>Dok_Aneks 1.6 Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik PITAGORA</i> <i>Dok_Aneks 1.6.1 Manual i sistemit elektronik PITAGORA</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Të gjithë informacionet për studentët dhe aktivitetet e tyre menaxhohen përmes sistemit PITAGORA, i cili ofron një sekretari elektronik të plotë. Po ashtu, PITAGORA menaxhon dokumentacionin lidhur me vlerësimin e studentëve, ndërsa regjistrat e pedagogëve kontrollohen nga përgjegjësi i departamentit dhe ekipi i punës i ngritur nga Rektorati çdo vit akademik. Ky sistem përdoret nga studentët, pedagogët dhe sekretarët dhe ka integruar gjithashtu një sistem pagesash me bankë për tarifat dhe pagesat për shërbime. Për çdo përdorues është hartuar një udhëzues për përdorimin e modulit përkatës. <i>Referenca:</i> <i>Dok_Aneks 1.6.1 Manual i sistemit elektronik PITAGORA</i> <i>Dok_Aneks 3.2 Raport përfundimtar auditimi</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të	Sistemi PITAGORA siguron akses të dedikuar dhe është i mbrojtur nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu, mundëson monitorimin e aktiviteteve

gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	akademike dhe administrative nga drejtuesit dhe titullarët e institucionit përmes raporteve që krijohen automatikisht. Referenca: <i>Linku për aplikacionin që mundëson komunikimin interaktiv</i> https://unkorce.edu.al/lms-2/
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Platforma të tjera që mundësojnë përmirësimin e cilësisë së mësimnxënies dhe komunikimit interaktiv përfshijnë <u>Aplikacionin Moodle</u> dhe aplikacione të tjera përmes Paketës "Office 365 for Education", që sigurojnë mundësi për stafin dhe studentët të përdorin platformat më të avancuara për mësimdhënie dhe komunikim online në çdo kohë dhe vend përmes internetit. Referenca: <i>Linkun për manualin e përdorimit të librarisë elektronike gjendet në</i> https://unkorce.edu.al/archive/bibliotekat/shk/ <i>Linku për aplikacionin që mundëson komunikimin interaktiv</i> https://unkorce.edu.al/lms-2/
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Është konstatuar nga RVB dhe gjatë vizitës së GVJ-së në UNIKO se sistemi i menaxhimit funksionon në mënyrë efektive, duke garantuar monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Gjithashtu, sistemi mundëson raportime individuale dhe ofron të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit. <i>Megjithatë, GVJ nuk konstaton në RVB apo gjatë vizitës paraqitjen e evidencave për adresimin e rekomandimeve të KLSH për marrjen e masave për adresimin e gjetjeve sipas raportit përfundimtar të auditimit (2023): "IAL-të duke mos e njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi E-Learning e miratuar nga Këshilli i Ministrave të vendeve anëtare të BE-së."</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 1.6.1 Manual i sistemit elektronik PITAGORA</i> <i>Dok_Aneks 3.2 Raport përfundimtar auditimi</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Referuar vizitës në IAL dhe kontrollit të website-it zyrtar të UNIKO, konstatohet se për informacion mbi programin "Master Profesional në Bankë dhe Sigurime" në faqen zyrtare të internetit të UNIKO (https://unkorce.edu.al/) gjendet plani mësimor dhe skeda e programit në gjuhën shqipe. Sipas konstatimit të GVJ, në faqen e internetit të UNIKO nuk ka publikim të informacionit në gjuhën angleze, duke rezultuar kështu në një kriter të pa plotësuar. Referenca: <i>Vizita në IAL dhe verifikimi website nga GVJ.</i> <i>website i UNIKO: https://unkorce.edu.al/.</i> <i>https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?fakulteti=fe&tipi=mp&programi=bansig</i>
Konkluzione	GVJ konkludon se nuk gjen të evidentuar me fakte nëse UNIKO e ka adresuar rekomandimin e dhënë nga KLSH për marrjen e masave për adresimin e

	gjetjeve sipas raportit përfundimtar të auditimit (2023): "IAL-të, duke mos e njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi E-Learning e miratuar nga Këshilli i Ministrave të vendeve anëtare të BE-së...dëshmojnë se kanë mangësi lidhur me informacionin që lidhet me praktikën e e-learning...". Vlerësojmë pozitivisht punën e bërë nga NJSBC pranë UNIKO, e cila ka evidentuar këtë mangësi në raportet e saj dhe ka theksuar nevojën për përmirësim në këtë drejtim.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas RVB-së, bazuar në nenin 84 të statutit të UNIKO, hartimi i buxhetit të UNIKO fillon nga njësisë bazë, Departamenti i Financë-Kontabilitetit për këtë program studimi. Në këtë fazë, merren parasysh nevojat financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Administrata e Universitetit harton projekt-buxhetin për njësitë ndihmëse dhe së bashku me projekt-buxhetet e njësive kryesore, harton projekt-buxhetin e vitit respektiv. Gjithashtu, burimet financiare shpërndahen dhe përdoren sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit dhe realizohet në dy faza: a) Hartimi dhe miratimi i buxhetit nga granti i pakushtëzuar që akordohet nga MAS b) Buxheti nga të ardhurat e Universitetit, bazuar në nenin 78 të statutit të UNIKO. Në gjysmën e dytë të çdo viti, bazuar në nenin 77 të statutit, UNIKO kryen procedurat për miratimin e projekt-buxhetit afatmesëm, i cili mbështetet tek kërkesat e njësive kryesore dhe ndihmëse, për të cilin ndiqet e njëjta procedurë si për hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor. Bordi i Administratës siguron qëndrueshmërinë financiare të UNIKO, sipas statutit të universitetit. Miratimi i buxhetit afatmesëm për tre vjet dhe burimet e tij, si tarifën e studentëve dhe granti i pakushtëzuar nga MAS, janë indikatorë të qëndrueshmërisë financiare të universitetit. UNIKO harton një plan financiar që përfshin ndarjen e burimeve financiare sipas kategorive të ndryshme, si financimi i burimeve njerëzore (paga dhe shpërblime), shpenzimet operative për mirëmbajtjen e ambienteve dhe pasurimin e literaturës. GVJ, bazuar në evidencat e dorëzuara, konstaton se kostoja mesatare për student "Grant i Buxhetit të Shtetit" ka një tendencë rritjeje të dukshme për çdo vit akademik. Sipas RVB-së, nuk evidentohet nëse UNIKO harton një plan financiar të dedikuar për këtë program studimi. Në përfundim, GVJ konkludon se, pavarësisht se UNIKO është një IAL publike, hartimi dhe miratimi i buxhetit të Universitetit duhet të mbështetet mbi analizën e kostos për student për çdo program studimi.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura	Referenca:

në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	<i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.10 Kosto mesatare për student</i> <i>Dok_Aneks 3.30 Buxhetet e UNIKO</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Evidentojmë se GVB shprehet se UNIKO respekton ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, dhe çdo vit dorëzon pasqyrat financiare pranë MAS dhe Degës së Thesarit të Korçës. Universiteti i nënshtrohet auditimit financiar nga Audit i Brendshëm i MAS dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe rezultatet e auditimit publikohen në faqen zyrtare të universitetit dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raporti i aktivitetit financiar diskutohet me organet kolegjiale të universitetit, përfshirë Rektoriatin, Bordin e Administratës dhe Senatin Akademik, dhe është i disponueshëm për gjithë personelin dhe studentët e interesuar. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i UNIKO, Neni 85</i> <i>Dok_Aneks 3.2 Raport përfundimtar auditimi</i> <i>Dok_Aneks 3.10 Kosto mesatare për student</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Referuar RVB, shpërndarja e burimeve bëhet në përputhje me strukturën e Buxhetit të Shtetit dhe realizohet në: Hartimin dhe miratimin e buxhetit nga granti i pakushtëzuar i MAS dhe buxheti nga të ardhurat e vetë Universitetit. Gjatë gjysmës së dytë të çdo viti, Universiteti fillon procedurat për hartimin e projekt-buxhetit afatmesëm, bazuar në kërkesat e njësisë kryesore dhe ndihmëse si dhe ndjek të njëjtën procedurë si për buxhetin vjetor. Ky plan përcakton prioritetet për investimet gjatë tre viteve të ardhshme në përputhje me nevojat infrastrukturore dhe logjistike. Burime të tjera financimi, por me kontribut modest për shpenzimet e UNIKO, janë: 1. Pagesat nga studentët; 2. Të ardhurat nga shërbimet; 3. Marrëdhëniet me palët e treat; 4. Donacione dhe burime të tjera ligjore; 5. Si dhe të ardhurat nga aktivitetet kërkimore-shkencore. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.2 Raport përfundimtar auditimi</i> <i>Dok_Aneks Link 5.12 Programi i transparencës - Rezultatet e Auditit</i> http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/transparenca/auditim_0.pdf
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe	Referuar RVB, përgatitja e buxhetit të UNIKO fillon nga njësitë bazë, të cilave u kërkohet të dërgojnë nevojat financiare për zhvillimin e programeve të studimit për një cikël të plotë të tyre. Po kështu vepron edhe Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit për parashikimin e nevojave për buxhet dhe këto i propozon Dekanatit për miratim. Administrata e Universitetit përgatit projektbuxhetin dhe merr miratimet e nevojshme për buxhetin e vitit përkatës dhe financimin e tij nga buxheti i shtetit. Menaxhimi i shpenzimeve bëhet nga një njësi e caktuar nën mbikëqyrjen e Rektoratit, e cila kujdeset që kërkesat e çdo njësie bazë të plotësohen sipas parashikimeve. Gjithashtu, në fund të çdo cikli të studimit, universiteti dokumenton të ardhurat dhe financimet për tre

diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	vitet akademike të kaluara për të bërë planifikimin e shpenzimeve dhe përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit. Referenca: Dok_Aneks 1.1 Statuti i UNIKO Dok_Aneks 3.2 Raport përfundimtar auditimi Dok_Aneks 3.30 Buxhetet e UNIKO			
Konkluzione	GVJ konkludon se kostoja mesatare për studentin në kuadër të "Grantit të Buxhetit të Shtetit" ka një tendencë rritjeje. Në përfundim, GVJ thekson se, megjithëse UNIKO është një IAL publike, hartimi dhe miratimi i buxhetit të Universitetit duhet të mbështetet në analizën e kostos për student për çdo program studimi. Ky proces ka si qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për menaxhimin efikas të fondeve të marra nga buxheti i shtetit, si dhe orientimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së UNIKO në arritjen e misionit të tij, përmes analizës dhe përcaktimit të strategjive konkrete për çdo njësitë bazë dhe program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me Statutin e UNIKO-s dhe dispozitat e Ligjit nr. 80/2015, Universiteti i Korçës ka përcaktuar qartë procedurat dhe politikat që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve të këtij programi, nga momenti i pranimit deri në përfundimin e studimeve. Në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit Ekonomik përshkruhen në detaje rregullat që lidhen me regjistrimin e studentëve, hartimin e planeve mësimore, strukturën e vitit akademik, organizimin e provimeve, si dhe procedurat për përgatitjen dhe shpërndarjen e diplomave. Po ashtu, në rregulloren e programit të studimit, e cila është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015, janë përcaktuar edhe procedurat që lidhen me tërheqjen e diplomës. Referenca: Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli' Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Email: info@ascal.al

	<i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 2.5 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime"</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Referuar RVB, evidentojmë një seri dokumentesh të përfshira në aktet rregullatore të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, duke nisur nga pranimi deri te diplomimi, në përputhje me ligjin në fuqi. Këto dokumente përfshijnë: Statutin e UNIKO (Kreu VI, Nenet 51-52, 56-57, 65-72), Rregulloren e UNIKO (Kreu VI, Nenet 47-48, 57, 59-60, 62-70, 72-74; Kreu VII, Nenet 76-99), Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë (Kreu IV, Nenet 29-30; Kreu VI, Nenet 42-49; Kreu VIII, Nenet 63-67), Rregulloren e Brendshme të Departamentit të Financë-Kontabilitetit (Kreu IV, Nenet 15-16; Kreu VI, Nenet 23-27; Kreu VII, Nenet 28-29; Kreu VIII, Nenet 31-34), Rregulloren e Programit të Studimit të MP në "Bankë dhe Sigurime" (seksioni 8 si dhe 11-16), dhe Manualin e Sistemit PITAGORA, i cili reflekton kërkesat për përdorimin e sistemit të informacionit Pitagora nga UNIKO. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 1.6 Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Përmes këtyre procedurave dhe politikave, sigurohet një trajtim i barabartë dhe i drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët që ndjekin programet e studimit. Ky angazhim është i shprehur qartë në Rregulloren e Programit të Studimit për MP në "Bankë dhe Sigurime", e cila trajton në detaje shkeljet e integritetit akademik. Dokumentet përkatëse, që përfshijnë procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, avancimin gjatë programit të studimit, transferimin e krediteve dhe njohjen e studimeve të mëparshme, janë hartuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për studentët dhe palët e tjera të interesuara. Të gjitha këto informacione janë të aksesueshme në faqen zyrtare të internetit të UNIKO, duke mundësuar një qasje të lehtë dhe të plotë për të gjithë të interesuarit. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 2.5 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime"</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Sipas Rregullores së Brendshme të Departamentit të Financë-Kontabilitetit (Kreu II, Neni 5), ky departament propozon kriteret e pranimi të studentëve për çdo program studimi. Kriteret e pranimi për çdo vit akademik përgatiten dhe miratohen nga Drejtoria e Fakultetit të Ekonomisë dhe më pas paraqiten për miratim në Senatin Akademik. Pas miratimit, këto kriteret i dorëzohen ministrisë përgjegjëse për arsimin. Këto kriteret bëhen publike dhe shpjegohen për të informuar sa më mirë të gjithë të interesuarit. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i>

	<i>Dok_Aneks 2.22 Kriteret e pranimi në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Financë-Kontabilitet" dhe Master Profesional "Bankë dhe Sigurime"</i> <i>Dok_Aneks Link 5.1 Website i UNIKO, https://unkorce.edu.al/</i> <i>Dok_Aneks 2.23 Për vlerësimin dhe ekuivalentimin e dosjeve të kandidatëve për transferim studimesh dhe për program të dytë studimi</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në sekretarinë e IAL-së u bë me dije se regjistrimi i studentëve në programin e studimeve MP në "Banka dhe Sigurime" kryhet pranë tyre duke respektuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues, duke garantuar barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student. Për tu evidentuar është edhe konstatimi i kryer në verifikim e bërë në web të UNIKO, ku gjenden të publikuara të gjitha kriteret dhe procedurat që kanë të bëjnë me pranimin, përzgjedhjen e studentëve, përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit për cilindo prej studentëve që ndjek këtë program studimi. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.22 Kriteret e pranimi në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Financë-Kontabilitet" dhe Master Profesional "Bankë dhe Sigurime"</i> <i>Dok_Aneks Link 5.1 Website i UNIKO, https://unkorce.edu.al/</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Regjistrimi i studentëve në programin MP në "Banka dhe Sigurime" kryhet duke respektuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues, duke siguruar barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët. Kjo garanton një proces të hapur dhe të drejtë për të gjithë studentët, përfshirë ata që mund të jenë pjesë e grupeve të veçanta si kandidatë me aftësi të veçanta, të pakica ose shtresa të marginalizuara. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 2.22 Kriteret e pranimi në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Financë-Kontabilitet" dhe Master Profesional "Bankë dhe Sigurime"</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Përpara çdo viti akademik, UNIKO harton dhe publikon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, grupe të pakicave, shtresave të marginalizuara dhe studentëve nga shtete të tjera, në përputhje me Udhëzimin Nr. 10, datë 15.05.2019. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 2.22 Kriteret e pranimi në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Financë-Kontabilitet" dhe Master Profesional "Bankë dhe Sigurime"</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në	UNIKO ka politika për mbështetje financiare për studentët që ndodhen në nevojë dhe ofron përparësi për ata që kontribuojnë në zhvillimin e programit dhe të ekonomisë kombëtare, në përputhje me Vendimin Nr. 780, datë 26.12.2018.

programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<i>Megjithëse në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së (2023) janë dhënë disa rekomandime të rëndësishme, GVJ nuk ka mundur të gjejë referenca të qarta në Rregulloren e Veprimtarisë Buxhetore (RVB) që të tregojnë nëse UNIKO i ka adresuar konkretisht këto rekomandime. Në veçanti, nuk ka evidenca që vërtetojnë nëse janë ndërmarrë masa për të rifreskuar marrëveshjet e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët privatë për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për studentët. Po ashtu, mungon dokumentimi për përcaktimin e qartë të tarifave lehtësuese në kuadër të këtyre marrëveshjeve, me synimin për të rritur efikasitetin e kartës së studentit në nivel rajonal.</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.2 Raport përfundimtar auditimi</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se, pavarësisht kujdesit të treguar nga IAL në përmbushjen e këtij standardi, nuk konstatohet një risk material në kriteret e trajtuara, duke qenë se programi i studimit, gjatë viteve të fundit, nuk ka arritur të plotësojë kuotat e miratuara të pranimit. Megjithatë, GVJ vëren se në Rregulloren e Veprimtarisë Buxhetore (RVB) nuk janë evidentuar referenca që tregojnë nëse UNIKO ka adresuar rekomandimet e dhëna nga KLSH në raportin përfundimtar të auditimit të vitit 2023. Konkretisht, mungojnë të dhëna që vërtetojnë:</i> <i>1. Marrjen e masave nga UNIKO për të rifreskuar marrëveshjet e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët privatë, për të mundësuar shërbime me çmime të reduktuara për studentët;</i> <i>2. Përcaktimin në kuadër të këtyre marrëveshjeve të tarifave lehtësuese për studentët, me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të kartës së studentit në nivel rajonal.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të dorëzuar nga UNIKO pranë ASCAL-it, si dhe nga takimet e zhvilluara me studentët dhe stafin akademik gjatë vizitës në institucion, konstatohet se studentët e regjistruar në këtë program kanë akses të plotë në informacionin që lidhet me ecurinë dhe progresin e tyre akademik. Ky informacion u ofrohet atyre përmes disa kanaleve komunikimi, ku një nga burimet kryesore është faqja zyrtare e internetit të UNIKO-s, e cila përmban të dhëna të përgjithshme dhe të përditësuara. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Dok_Aneks 2.5 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime"</i> <i>Vizita e GVJ në UNIKO</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UNIKO dhe Fakulteti Ekonomik informojnë studentët, në përputhje me rregulloret përkatëse, lidhur me kriteret për njohjen e studimeve të mëparshme, duke përfshirë llojin e institucionit arsimor dhe nivelin e plotë apo të pjesshëm të studimeve të kryera. Institucioni pranon transferime studimi nga programe, fakultete apo universitete të tjera, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij, me kusht që të respektohen kërkesat për kredite sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" Statutit dhe Rregullores së UNIKO-s. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 2.23 Për vlerësimin dhe ekuivalentimin e dosjeve të kandidatëve për transferim studimesh dhe për program të dytë studimi</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në Rregulloren e Programit të Studimit të Masterit Profesional në "Bankë dhe Sigurime" si dhe në Rregulloren e FE janë përfshirë informacione që trajtojnë vlerësimin e njohurive dhe format e vlerësimit akademik. Procedurat janë të përcaktuara qartë, duke përfshirë llojet e provimeve, provimet e pjesshme dhe ato përfundimtare për çdo lëndë, si dhe mënyrat e organizimit dhe hartimit të tezave. Gjithashtu, janë detajuar procedurat për miratimin e tezave, si nga aspekti administrativ ashtu edhe nga ai akademik, së bashku me elementë të tjerë të domosdoshëm për realizimin e procesit të vlerësimit. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 2.5 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime"</i> <i>Dok_Aneks 3.27 Kurrikula e programit të studimit MP në "Bankë dhe Sigurime"</i> <i>Dok_Aneks 3.24 Fletëpalosje informuese rreth programeve të studimit të ofruar nga FE</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Informacioni më specifik që lidhet me diplomimin e studentëve të këtij programi studimi gjendet i përshkruar në Rregulloren e Programit të Studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime", Seksioni 15. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.5 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime"</i> <i>Dok_Aneks 2.31 Udhëzuesi i diplomës MP në "Bankë dhe Sigurime"</i>

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Ky informacion u ofrohet studentëve përmes disa kanaleve komunikimi, siç parashikohet në Rregulloren e njësisë kryesore, Kreu XV, Neni 114. Për informimin e studentëve të ardhshëm dhe të interesuarve të tjerë mbi programin e studimit, Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në “Bankë dhe Sigurime” ka një rol orientues dhe udhëzues. Gjithashtu, Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) kontribuon në këtë proces duke hartuar dhe shpërndarë materiale informuese si fletëpalosje për studentët e ardhshëm, si dhe duke organizuar takime prezantuese me ta. Këto veprimtari mbështeten në Rregulloren e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, Kreu III, Neni 9, pika 3, dhe Neni 10, pikat 11 dhe 12. Një përmbledhje e detajuar e punës së QKA për vitin akademik përkatës paraqitet në dokumentin e Analizës së Veprimtarisë. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 3.18 Analiza e veprimtarisë së Qendrës së Karrierës dhe Alumnit</i> <i>Dok_Aneks 3.24 Fletëpalosje informuese rreth programeve të studimit të ofruar nga FE</i> <i>Dok_Aneks 2.22 Kriteret e Pranimi në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Bankë dhe Sigurime”</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se UNIKO disponon një dokumentacion të plotë dhe të strukturuar që siguron informimin e studentëve mbi kriteret e pranimi, detyrimet që lidhen me ndjekjen e programit të studimit, rregullat dhe afatet për përmbushjen e këtyre detyrimeve, si dhe procedurat dhe kriteret për hartimin e temës së diplomës dhe procesin e diplomimit. Po ashtu, janë të përcaktuara qartë edhe kriteret për pranimin dhe transferimin e studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime", së bashku me shtojcat shoqëruese, ofron një informacion të plotë dhe të detajuar mbi objektivat formues, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit. Gjithashtu, ajo pasqyron qartë rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit që ofron programi pas përfundimit të tij. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.5 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime"</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të	Në Rregulloren e Programit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime", si dhe në Kurrikulën e këtij programi, përveç informacionit të tjera të dobishëm, është paraqitur edhe programi mësimor i strukturuar sipas lëndëve/moduleve, duke specifikuar ngarkesën mësimore në auditor dhe jashtë tij. Po ashtu,

posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	studentët njoftohen me përmbajtjen e programit për secilën lëndë që në fillim të procesit mësimor. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.5 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime"</i> <i>Dok_Aneks 3.27 Kurrikula e programit të studimit MP në "Bankë dhe Sigurime"</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	UNIKO ka përfshirë në strukturën e tij organizative Qendrën e Karrierës dhe Alumni (QKA), e cila ofron mbështetje për studentët lidhur me mundësitë e punësimit. QKA i ndihmon studentët duke i trajnuar dhe orientuar ata për tregun e punës, duke përdorur informacionin që mbledh nga të dhënat e disponueshme, sipas Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, Kreu III, Neni 9, pikat 6-7 dhe 10. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI</i> <i>Dok_Aneks 3.18 Analiza e veprimtarisë së Qendrës së Karrierës dhe Alumnit</i> <i>Dok_Aneks 3.17 Të dhënat e gjurmimit të punësimit të studentëve që kanë përfunduar studimet në programin e studimit "Master Profesional" në Bankë dhe Sigurime</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në fillim të çdo viti akademik ose semestri, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit përgatisin dhe publikojnë: 1. Strukturën mësimore të programit të studimit ; 2. Orarin e mësimi, siç kërkohet nga Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu IX, Neni 69. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit Financë-Kontabilitet</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit ofrohet përmes disa kanaleve, siç parashikohet në Rregulloren e Brendshme të Departamentit të Financë-Kontabilitetit, Kreu VII, Neni 29, dhe përmes sistemit të menaxhimit të informacionit PITAGORA, i cili shpjegohet në manualin e sistemit elektronik PITAGORA, në faqet 18-19. Ky informacion mund të sigurohet gjithashtu nga strukturat si: Sekretaria Mësimore, Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), dhe stafi akademik. <i>Megjithatë, GVJ bazuar në tabelat pjesë e RVB-së vlerëson se nuk është bërë mjaftueshëm duke konstatuar tregues të ulët në nivelin e punësimit të studentëve të diplomuar në këtë program studimi sipas edhe profilit të tyre, ose mos njohje e treguesve të vërtetë e evidentuar kjo edhe gjatë vizitave në IAL</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Dok_Aneks 3.17 Të dhënat e gjurmimit të punësimit të studentëve që kanë përfunduar studimet në programin e studimit "Master Profesional" në Bankë dhe Sigurime</i>
	<i>Dok_Aneks 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Dok_Aneks 3.17 Të dhënat e gjurmimit të punësimit të studentëve që kanë përfunduar studimet në programin e studimit "Master Profesional" në Bankë dhe Sigurime</i>

	<i>Dok_Aneks 3.19 Raport Vjetor mbi Cilësinë në Hyrje dhe Dalje dhe të Punësimit të Studentëve të Programit të Studimit Master Profesional në Bankë dhe Sigurime</i>			
Konkluzione	<i>Në përfundim, lidhur me këtë standard, GVJ thekson se është e nevojshme që IAL të gjejë mekanizmat nxitës për të siguruar që stafi akademik dhe zyrat përkatëse të jenë aktive dhe efikase në përfshirjen e studentëve. Kjo përfshirje duhet të krijojë mundësi për ata që të marrin eksperiencën e parë profesionale dhe, më pas, të integrohen në tregun e punës në profesionet e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																	
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë vizitës në UNIKO, GVJ verifikoi informacionet e evidentuara në RVB, duke verifikuar që sekretaria mësimore e DFK disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve, numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit ose mospërfundimin me sukses të vitit akademik gjatë të cilit zhvillohet programi i studimit. GVJ konstatoi se të dhënat e cituara më sipër ruhen në formë të shkruar (hard copy) sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 71 të statutit të UNIKO-së, i cili detyrohet të mbajë të dhënat në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”: a) Regjistri themeltar i studentëve të UNIKO-së, i cili është i plotësuar gjithashtu në formë elektronike (Rregullore e Sekretarisë, neni 13); b) Regjistri i arritjeve akademike për çdo student të regjistruar në UNIKO për këtë program studimi, gjithashtu i plotësuar në formë elektronike; c) Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave, gjithashtu i plotësuar në formë elektronike, në përputhje me kërkesat e Rregullores së këtij sektori të UNIKO-së, Nenet 5-14.																	
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<table><tr><th rowspan="2">Viti</th><th colspan="2">PS_MP_Banke&Sigurime</th></tr><tr><th>Studentë të regjistruar</th><th>Studentë të diplomuar</th></tr><tr><td>Viti 2023-2024</td><td>4</td><td>4</td></tr><tr><td>Viti 2022-2023</td><td>8</td><td>7</td></tr><tr><td>Viti 2021-2022</td><td>7</td><td>5</td></tr><tr><td>Totali</td><td>19</td><td>16</td></tr></table>	Viti	PS_MP_Banke&Sigurime		Studentë të regjistruar	Studentë të diplomuar	Viti 2023-2024	4	4	Viti 2022-2023	8	7	Viti 2021-2022	7	5	Totali	19	16
Viti	PS_MP_Banke&Sigurime																	
	Studentë të regjistruar	Studentë të diplomuar																
Viti 2023-2024	4	4																
Viti 2022-2023	8	7																
Viti 2021-2022	7	5																
Totali	19	16																
	Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.9 Analiza vjetore e veprimtarisë së Fakultetit Ekonomik</i> <i>Dok_Aneks Tabela 23 “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve; Vizita e GVJ në institucion</i>																	

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Neni 113 i Kreut XV të Rregullores së Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë thekson rëndësinë e ruajtjes së të dhënave personale të studentëve. Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik PITAGORA, në seksionin "Studentët" të faqe 21, dhe në seksionin "Siguria e të dhënave: Konfidencialiteti, Integritimi, Vlefshmëria", shpjegon se ky sistem i brendshëm mundëson menaxhimin e të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri te diplomimi, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave dhe mundësinë e verifikimit nga personat e autorizuar. Kjo është gjithashtu e specifikuar në Statutin e UNIKO-së, Kreu VIII, Neni 83. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 3.9 Analiza vjetore e veprimtarisë së Fakultetit Ekonomik</i> <i>Dok_Aneks 1.6 Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik PITAGORA;</i> <i>Dok_Aneks 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe e Sektorit të TIK</i>			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimor, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	UNIKO siguron mbështetje përmes aktesh dhe kontrollon periodikisht njësitë përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave, duke vlerësuar dhe dokumentuar saktësinë e informacionit dhe dokumenteve që lidhen me studentët dhe aktivitetet e tyre. Kjo është përfshirë në Rregulloren e Sektorit të Studimeve dhe të Sektorit të TIK, Kreu II, Nenet 10, 11, 12. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dok_Aneks 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe e Sektorit të TIK</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	QKA duhet të mbledhë të dhëna mbi punësimin e studentëve në përputhje me Rregulloren e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, Kreu III, Neni 9, pika 7, Neni 10, pikat 4 dhe 19, dhe t'i përditësojë ato në databazat përkatëse. Ndërkohë, të dhënat e raportuara në "Tabelën 23" nuk rezultojnë optimiste dhe nuk janë të sakta, sipas kontestimeve të bëra gjatë vizitës në IAL. GVJ sugjeron që të dhënat mbi punësimin e studentëve të këtij programi të përditësohen dhe saktësohen me një frekuencë të paktën çdo 6 muaj. Këto të dhëna duhet të përdoren nga UNIKO për të përgatitur raporte analitike periodike për programin e studimit, si dhe të përfshihen në Analizën Vjetore të Veprimtarisë së Fakultetit të Ekonomisë dhe në raporte të tjera nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit.			
Konkluzione	<i>GVJ rekomandon që të dhënat mbi punësimin e studentëve të këtij programi të përditësohen dhe verifikohen çdo 6 muaj. Këto informacione duhet të përdoren nga UNIKO për të përgatitur raporte analitike periodike për programin e studimit dhe të integrohen në Analizën Vjetore të Veprimtarisë së Fakultetit të Ekonomisë, si dhe në raporte të tjera të Departamentit të Financë-Kontabilitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UNIKO, në përputhje me nenet 98 dhe 99 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, si dhe me nenin 69 të Statutit të vet, garanton të drejtën e studentëve për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur si përfaqësues në organet vendimmarrëse të institucionit, duke përfshirë Senatin Akademik (me përfaqësim prej 10%) dhe komisionet përkatëse. Në bazë të Raportit të Vetëvlerësimit (RVB), Rektorati i UNIKO mbështet nismat dhe kërkesat e Këshillit Studentor, duke marrë miratimin nga organet akademike dhe administrative përkatëse, sipas fushës së veprimtarisë, lidhur me çështje që kanë të bëjnë me financimin, përfshirjen akademike të studentëve, si dhe organizimin e aktiviteteve studentore. Këto aspekte janë të verifikueshme edhe përmes faqes zyrtare të institucionit. Studentët gëzojnë gjithashtu të drejtën për t’u zgjedhur në Këshillin e Studentëve të njëjseve përkatëse dhe në atë institucional. Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu XIV, Neni 108, thekson të drejtën e studentëve për t’u organizuar në struktura përfaqësuese në nivel njësie, institucional dhe kombëtar. Statuti i UNIKO-së, Kreu III, Neni 18, pika 31, përcakton që Senati Akademik zgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës dhe të Komisioneve të Përhershme, në të cilat përfshihen edhe përfaqësues të studentëve. Sipas Nenit 29, pika 4 të Statutit, një nga shtatë anëtarët e Këshillit të Etikës është përfaqësues i studentëve. Korniza ligjore dhe rregullatore e brendshme e UNIKO-s garanton përfshirjen aktive të studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshillimore që lidhen me zhvillimin, miratimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, metodologjive të mësimdhënies, si dhe cilësinë e burimeve dhe shërbimeve që u ofrohen atyre. Sipas të dhënave të RVB-së, studentët plotësojnë një pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mënyrës së vlerësimit të dijes për çdo modul përpara çdo sezoni provimesh. Pas analizimit të rezultateve të këtij pyetësori, pedagogët marrin në konsideratë ankesat dhe sugjerimet e studentëve për të përmirësuar syllabusin dhe metodat e mësimdhënies. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit ‘Fan S. Noli’</i> <i>Dok_Aneks 1.18 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve në UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.20 Rregullore e Bordit të Administrimit</i> <i>Dok_Aneks 1.19 Kodi i etikës së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.20 Rregullore e Bordit të Administrimit</i> <i>Dok_Aneks 3.8 Lista e NJSBC-së</i> <i>Dok_Aneks 3.8.a Lista e NJSBC-së së Fakultetit Ekonomik dhe vendimi nr. 596, datë 16.09.2024 për ndryshimin e anëtarëve të Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e	Sipas të dhënave të përfshira në GVB, Statuti i Universitetit të Korçës (UK), Kreu VIII, Neni 80, pika 2, përcakton se këshillat studentore kanë për detyrë të promovojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin

hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	e tyre në organet drejtuese të UNIKO. Më tej, në pikën 7 të po këtij neni, theksohet se këto këshilla shprehin opinione dhe japin propozime mbi çështje me interes të gjerë institucional, përfshirë programet e studimit, cilësinë e shërbimeve dhe shpërndarjen e burimeve financiare. Gjithashtu, Statuti i UNIKO-së në Kreun IX, Neni 73, pika 2, si dhe Neni 85, pika 1, parashikon që në kuadër të sigurimit të cilësisë së brendshme, brenda Sektorit të Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, funksionon Njësia e Sigurimit të Cilësisë, ku një prej anëtarëve është përfaqësues i studentëve. Kjo njësi është ngritur në nivel fakulteti, përfshirë Fakultetin e Ekonomisë, si dhe në çdo njësi tjetër, duke garantuar përfaqësimin nga çdo departament dhe nga strukturat studentore.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në përputhje me VKM nr. 782, datë 26.12.2018, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin në institucionet publike të arsimit të lartë", përcaktohet se një përfaqësues i studentëve bën pjesë në Bordin e Administrimit, organi më i lartë drejtues administrativ në UNIKO. Kjo është e sanksionuar edhe në Statutin e UK-së, Kreu III, Neni 16, pika 4, ku Bordi i Administrimit përbëhet nga 7 anëtarë. Roli dhe funksionet e këtij Bordi janë të përcaktuara gjithashtu në Rregulloren e UNIKO, Kreu IV, Neni 25. Nga ana tjetër, Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu XIII, Neni 103, pika 2, përforcon përfshirjen e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes një pyetësori që plotësohet në fund të çdo semestri. Ky proces menaxhohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ku një nga tetë anëtarët është përfaqësues i studentëve, duke garantuar që opinionet e tyre të pasqyrohen në analizën përkatëse. Në përputhje me Rregulloren e UNIKO-së, Kreu VI, nenet 100-105, RVB thekson gjithashtu se Departamenti i Financë-Kontabilitetit (DFK), përmes procedurave të parashikuara, siguron barazi dhe transparencë në procesin e vlerësimit të studentëve. Kjo përfshin të drejtën e studentëve të programit MSc "Financë" për të paraqitur ankesa, për të kërkuar rishikimin dhe nëse është e nevojshme, reflektimin apo ndryshimin e vlerësimit përfundimtar të provimit. Në përfundim të vitit akademik 2020-2021, Departamenti i Financë-Kontabilitetit ndërmori procesin e rishikimit periodik të programeve të studimit, duke e iniciuar me një tryezë të rumbullakët të zhvilluar më 28 qershor 2021, e ndjekur nga dy takime të tjera pasuese. Gjatë vizitës në IAL, studentët deklaruan se sa herë kanë pasur ankesa lidhur me rezultatet apo kanë kërkuar rishikim të tyre, pedagogët kanë reaguar brenda afatit 48-orësh, duke mundur shqyrtimin në kohë të kërkesave. Sipas GVB-së, përmbledhja e propozimeve për përmirësime të mundshme të programeve të studimit, përfshirë programin MP në "Bankë dhe Sigurime", paraqitej në (Dok_Aneks 3.22). <i>Megjithatë, GVJ vërejtë se në këtë dokument mungonin analizat dhe përmbledhjet e detajuara të propozimeve që kërkohen në kriter.</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 1.17 Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>Dok_Aneks 1.18 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve në UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.19 Kodi i etikës së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.20 Rregullore e Bordit të Administrimit</i>

	<i>Dok_Aneks 3.22 Propozime të diskutuara në mbledhjet e departamentit në kontekst të ndryshimeve të programeve</i> <i>Dok_Aneks 3.28 Raporti i analizës së të dhënave të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për programet</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se UNIKO angazhon studentët në vlerësimin e procesit akademik, duke u mbështetur në të dhëna të matshme të mbledhura përmes pyetësorëve të hartuar dhe administruar nga NJBSC. Këto pyetësorë synojnë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për çdo lëndë dhe program studimi, përfshirë edhe programin Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në përputhje me kërkesat ligjore, struktura organizative e UNIKO-s përfshin Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, në përbërje të së cilës ndodhen edhe njësi të specializuara si Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA). Këto njësi kanë për mision informimin, këshillimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të progresit të studentëve. Në kuadër të Fakultetit të Ekonomisë funksionojnë gjithashtu Sekretaria Mësimore dhe Sekretaria e Departamentit, të cilat luajnë një rol aktiv në adresimin në kohë të nevojave dhe kërkesave të studentëve. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.23 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Projekteve dhe Kërkimit Shkencor</i> <i>Dok_Aneks 1.17 Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>Dok_Aneks 3.18 Analiza e veprimtarisë së Qendrës së Karrierës dhe Alumnit</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (DKVI), në Kreun I, Nenin 4, përcakton se ndër funksionet kryesore të kësaj drejtorie është edhe ndjekja e zhvillimit profesional të të diplomuarve të UNIKO-s. Kjo detyrë i është deleguar Qendrës së Karrierës dhe Alumni (QKA), sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren përkatëse, Kreu III, Neni 9, pika 7, si dhe Neni 10, pikat 4 dhe 19. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI</i> <i>Dok_Aneks 3.18 Analiza e veprimtarisë së Qendrës së Karrierës dhe Alumnit</i> <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i Cilësisë UNIKO</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës.	Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) ka si detyrë mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave mbi nivelin dhe cilësinë e punësimit të studentëve. Megjithatë, duket se një funksion i ngjashëm është parashikuar edhe për

Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë pranë Fakultetit të Ekonomisë, siç përcaktohet në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit, Kreu XIII, Neni 103, pika 2. Kjo njësi ka ndër detyrat e saj kryerjen e studimeve për të ndjekur ecurinë e punësimit të studentëve dhe për të vlerësuar efikasitetin e programeve që ofron fakulteti. <i>Megjithatë, të dhënat e paraqitura në Tabelën 23 nuk paraqesin një situatë optimiste sa i përket punësimit të të diplomuarve, ndërkohë që informacioni i publikuar në faqen zyrtare të UNIKO-s shtrihet vetëm deri në vitin akademik 2021–2022.</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 3.18 Analiza e veprimtarisë së Qendrës së Karrierës dhe Alumnit</i> <i>Dok_Aneks 4.14 Tabela 23</i> <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Baza e të dhënave për gjurmimin e studentëve të diplomuar në website</i> https://unkorce.edu.al/qka-statistika-2/			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.				
Konkluzione	GVJ vlerëson se kriteret janë të përmbushura, duke pasur parasysh një sërë aspektesh pozitive të konstatuara gjatë vlerësimit. Megjithatë, thekson rëndësinë e marrjes në konsideratë të disa rekomandimeve të përfshira në Standardin V.4.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në përputhje me RVB dhe pas vizitës në institucion, GVJ vlerëson se UNIKO, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, pika 1, si dhe në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit, ka hartuar politika dhe ka ngritur struktura të dedikuara për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke përfshirë gjithashtu programin Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime". Referenca:

	<i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në UNIKO janë specifikuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, i miratuar me Vendimin nr. 300, datë 10.07.2020, nga Senati Akademik. Ky manual pasqyron parimet kryesore të funksionimit të strukturës së sigurimit të cilësisë dhe ofron udhëzime për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, duke siguruar përputhshmërinë me standardet akademike. Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është NJSBC, e cila është parashikuar si strukturë në Statutin e UNIKO. Politikat për sigurimin e cilësisë janë publikuar bashkë me Planin Strategjik, i cili përcakton procedurat dhe politikat që do të ndiqen për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC përbëhet nga përfaqësues nga çdo njësi kryesore, studentë dhe ekspertë të jashtëm. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.8.a Lista e NJSBC-së së Fakultetit Ekonomik dhe vendimi nr. 596, datë 16.09.2024 për ndryshimin e anëtarëve të Njësise për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Sipas RVB, GVB kryen vlerësimin e brendshëm të programit të studimit një herë në vit, dhe ky vlerësim përdoret si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe për vlerësimin e jashtëm. <i>Megjithatë, GVJ nuk ka gjetur evidenca që tregojnë se çfarë masash janë marrë në rastin e identifikimit të mospërputhjeve në përmbushjen e standardeve të cilësisë, sipas manualit, për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Bordi ASCAL apo ato të KLSH-së.</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.7 Raportet vjetore të NJSBC-së</i> <i>Dok_Aneks 3.13 Pyetësor studentor fund kursi</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel njësie kryesore bëjnë publike të dhënat e tyre përmes raporteve vjetore. NJSBC-ja gjithashtu harton Raportet e Vlerësimit të Brendshëm, të cilat paraqesin rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për programet e studimit të ofruara nga UNIKO. UNIKO publikon në website disa raporte periodike që përmbajnë të dhëna mbi performancën e mësimdhënies. Këto raporte janë të aksesueshme për studentët, stafin dhe publikun e gjerë, duke mundësuar që të gjitha palët e interesuara të monitorojnë dhe vlerësojnë përparimin e cilësisë, si dhe të promovojnë transparencën dhe angazhimin në proceset akademike. Referenca: <i>Dok_Aneks 3.7 Raportet vjetore të NJSBC-së</i> <i>Dok_Aneks 3.13 Pyetësor studentor fund kursi</i> <i>Dok_Aneks 3.9 Analiza vjetore e veprimtarisë së Fakultetit Ekonomik</i>

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në informacionin e ofruar nga RVB dhe gjatë vizitës në institucion, në takimet me stafin akademik dhe studentët e programit, GVJ vlerësoi analizën e raporteve të vlerësimeve të personelit në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. Këto vlerësime bëhen pjesë e mbledhjeve të departamentit, ku diskutimet konstruktive promovojnë praktikën e mira dhe nxisin personelin akademik të vazhdojë përpjekjet për përmirësim të mëtejshëm. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i Cilësisë UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.9 Analiza vjetore e veprimtarisë së Fakultetit Ekonomik</i> <i>Dok_Aneks 3.7 Raportet vjetore të NJSBC</i> <i>Dok_Aneks 2.20 Analiza e Veprimtarisë UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion nga GVJ</i>			
Konkluzione	GVJ nuk ka gjetur evidenca që tregojnë masat e marra për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Bordi ASCAL, KLSH, apo NJSBC. GVJ rekomandon që NJSBC të mbajë evidenca të plota që reflektojnë ndjekjen e plotësimin të rekomandimeve të dhëna në raportet e posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, si pjesë e strukturave dhe sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ thekson se DFK është njësi kryesore që ka përgjegjësinë dhe detyrimin për përmirësimin dhe rishikimin e programit mësimor. Ndërkohë, NJSBC-ja operon në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjitha programet e studimit. Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe Statutin e Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës, institucioni ka përgjegjësinë për zhvillimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë. Organet kolegjiale, përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre, hartojnë politikat, strukturat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it, RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se në UNIKO është ngritur dhe operon NJSBC në nivel institucional. Në mbështetje të kësaj njësie janë politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe një sërë aktesh rregullative të institucionit, si Manuali i Brendshëm i Cilësisë, i miratuar me

cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Vendimin nr.16, datë 13.01.2025 të Senatit Akademik, në përputhje me Planin Strategjik 2022-2027. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i UNIKO, Kreu IX, Neni 84</i> <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Në përputhje me Planin Strategjik 2022-2027, të miratuar nga institucioni, janë përcaktuar politikat dhe procedurat për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Sipas Statutit të UK, është hartuar gjithashtu Manuali i Cilësisë i UNIKO, i cili përshkruan funksionimin e strukturës së cilësisë në UNIKO dhe siguron përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe sistemin e përgjithshëm të sigurimit të cilësisë. Ky manual është një dokument kyç që përcakton kornizën, strukturat, parimet, procedurat dhe standardet e sigurimit të cilësisë, dhe është i integruar në proceset e përditshme të stafit të UNIKO. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i UNIKO, Kreu IX, Neni 84</i> <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Përsa i përket RVB, evidentohet se në fund të vitit akademik, njësitë bazë realizojnë vlerësime për performancën e stafit akademik dhe për punën kërkimore shkencore, të cilat përfshihen në Raportin Vjetor. Ky raport analizohet dhe dërgohet për shqyrtim në nivel fakulteti. Ky proces është një komponent kyç i përpjekjeve për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe mësimdhënies në UNIKO. <i>Në RVB, mungojnë lidhjet për publikimin online të raporteve të vlerësimit të cilësisë. Megjithatë, ekspertët e vlerësimit të jashtëm kanë gjetur disa raporte të vendosura në website-in e UNIKO dhe e vlerësojnë këtë si një praktikë të mirë që ndihmon në rritjen e transparencës për pretendimet. GVJ i rekomandon Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të UNIKO që të kërkojnë një analizë (follow-up) për zbatimin e detyrave dhe masave të nevojshme për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara në këto raporte, në mënyrë që të sigurohet përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë.</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i UNIKO, Kreu IX, Neni 84</i> <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 2.20 Analiza e Veprimtarisë UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 3.9 Analiza vjetore e veprimtarisë së Fakultetit Ekonomik</i>

Konkluzione	GVJ vlerësojnë si një praktikë të mirë në plotësim të transparencës për pretendentët e UNIKO publikimin prej tyre të raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe disa analiza të gjetjeve nga përgjigjet e pyetësorëve të studentëve. GVJ i rekomandon Senatit Akademik, dhe Bordit të Administrimit të UNIKO të kërkojnë një analizë (follow up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga këto raporte për përmirësimin në vijim të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	UNIKO ka përgjegjësinë për t'i ofruar shoqërisë shqiptare programe mësimore me cilësi të lartë, duke treguar përpjekjet e mundshme për përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve të siguruar nga buxheti i shtetit dhe studentët e saj, si dhe duke siguruar përmbushjen e standardeve të cilësisë. GVJ konkludon se raportet dhe vlerësimet e NJSBC realizohen në nivel institucional, por nuk ka vlerësime specifike për këtë program nga NJSBC. Megjithatë, analiza e përgjithshme institucionale e DFK evidenton elementet që lidhen me programin MP në "Bankë dhe Sigurime". Për të rritur cilësinë e këtij programi studimi, UNIKO ka përdorur një gamë metodash dhe instrumentesh të përshtatshme, të cilat janë në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit. Këto përfshijnë sondazhe dhe intervista me studentët aktualë, të diplomuar (alumni), dhe me personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Referenca: Dok_Aneks 1.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI Dok_Aneks 2.20 Analiza e Veprimtarisë UNIKO Dok_Aneks 3.9 Analiza vjetore e veprimtarisë së Fakultetit Ekonomik Dok_Aneks 3.13 Pyetësor studentor fund kursi
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Sipas RVB-së, në nivel fakulteti është realizuar vetëvlerësimi, por nuk janë kryer vlerësime të jashtme dhe auditime. Njësia bazë harton çdo vit raportet e veprimtarisë institucionale, të cilat përfshijnë analizën e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor, duke vlerësuar të gjithë komponentët përkatës. Nga analiza e këtyre vlerësimeve janë nxjerrë rekomandime dhe janë përcaktuar detyra të lidhura me rregullsinë e procesit mësimor dhe cilësinë e mësimdhënies. Referenca: Dok_Aneks 3.9 Analiza vjetore e veprimtarisë së Fakultetit Ekonomik

Kriteri 3.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Sipas GVB, NJSBC luan një rol kyç në mbështetjen dhe ofrimin e ekspertizës për fakultetet dhe departamentet, duke realizuar vizita të rregullta dhe ofruar këshilla për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Ekspertiza e ofruar përqendrohet kryesisht në implementimin e mekanizmave të cilësisë për mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënit. NJSBC koordinon komunikimin ndërmjet strukturave të ndryshme të universitetit, veçanërisht kur proceset i delegohen fakulteteve ose kur realizohen vlerësime nga universiteti. Ky rol koordinues shtrihet edhe në njësitë e tjera të universitetit të përfshira në zhvillimin e personelit dhe mbledhjen/analizën e të dhënave institucionale. NJSBC siguron që detyrimet kombëtare dhe evropiane për sigurimin e cilësisë të adaptohen dhe zbatohet në kontekstin e universitetit, duke përfshirë këto detyrime në politikat dhe praktikat e universitetit. Referenca: <i>Dok_Aneks 3.7 Raportet vjetore të NJSBC-së</i> <i>Dok_Aneks 3.28 Raporti i analizës së të dhënave të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për programet e studimit në Fakultetin e Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 3.9 Analiza vjetore e veprimtarisë së Fakultetit Ekonomik</i>			
Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	NJSBC monitoron dhe udhëzon mbledhjen e të dhënave, si dhe evidentimin e problemeve që paraqiten, duke i dërguar ato në njësitë përkatëse për trajtim. Gjithashtu, NJSBC organizon vizita të vlerësimit të jashtëm dhe fton ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin përgjegjës për vlerësimin e brendshëm. Për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit të nivelit të dytë MP në “Bankë dhe Sigurime”, përdoren disa metoda vlerësimi, përfshirë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes kontrollit të dijeve, si testime të ndërmjetme, diskutime, studime rasti, ese, detyra dhe projekte. Vlerësimet paralele të provimeve realizohen kur ka ankesa nga studentët. <i>Përfundimisht, GVJ thekson se QKA duhet të përditësojë të dhënat mbi studentët e diplomuar dhe punëdhënësit, për të siguruar informacion më të fundit mbi tregun dhe nevojat e tij.</i> Referenca: <i>Dok_Aneks 3.7 Raportet vjetore të NJSBC-së</i> <i>Dok_Aneks 1.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI</i> <i>Dok_Aneks 3.9 Analiza vjetore e veprimtarisë së Fakultetit Ekonomik</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson punën e bërë dhe këshillon IAL-në që, përveç metodave aktuale, të përdorë edhe metoda dhe instrumente të tjera, si p.sh. vlerësimi 360 gradë. Po ashtu, GVJ ka theksuar edhe më herët se QKA duhet të përditësojë të dhënat mbi studentët e diplomuar dhe punëdhënësit, për të informacion më të fundit mbi tregun dhe nevojat e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel.: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacion e aplikimit pranë ASCAL dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UNIKO, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në Manualin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 2.4 Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Për të vlerësuar progresin e programeve, Departamenti dhe Fakulteti realizojnë analiza periodike të aktiviteteve të tyre. Gjetjet dhe sfidat që dalin diskutohen në mbledhje të hapura të Departamentit dhe Fakultetit, me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Studentët luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë, duke kontribuar dhe duke u përfshirë në struktura të ndryshme të Universitetit dhe Fakultetit përmes përfaqësuesve të tyre. Referenca: <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Dok_Aneks 2.4 Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Studentët e pyetur gjatë vizitës në IAL, lidhur me përfaqësuesit e tyre në këto struktura, shprehën se nuk kishin dijeni se kush i përfaqëson dhe si funksiononte procesi i përfaqësimit të tyre. Kjo mungesë informacioni ka krijuar një ndjesi pasigurie dhe mungesë angazhimi nga ana e studentëve. Në këtë kuadër, GVJ i sugjeron IAL-së që pas çdo lloji vlerësimi dhe analize të realizohet një ndjekje e vazhdueshme e masave të nevojshme dhe konkrete, të cilat duhet të përcaktohen në kohë dhe të implementohen pa vonesa. Kjo do të kontribuonte në një proces më transparent dhe të strukturuar, ku të gjithë palët e interesuara të kenë mundësinë të shohin rezultatet e masave të ndërmarra.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi	Po ashtu, GVJ rekomandon që pas çdo semestri të bëhet një vlerësim i detajuar mbi progresin ose regresin që mund të ketë pasur programi i studimit. Ky vlerësim duhet të përfshijë një analizë të plotë të efekteve të ndryshmeve të mundshme, si dhe të përcaktojë çdo axhustim që është i nevojshëm për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të përmbushur nevojat e studentëve.

apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Ky proces duhet të jetë dinamik dhe i vazhdueshëm, duke siguruar që cilësia të mbetet në nivele të larta, duke adresuar çdo sfidë që mund të lindë.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Për më tepër, është e domosdoshme që të zhvillohet një strategji e qartë dhe e detajuar për rritjen e numrit të studentëve në këtë program studimi, duke siguruar që cilësia e arsimit të ruhet dhe të forcohet vazhdimisht. Ky plan duhet të bazohet në një analizë të thelluar të zhvillimeve dhe nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë në nivelet lokale, rajonale dhe kombëtare. Kjo mund të arrihet përmes një strategjie të orientuar që merr parasysh mundësitë për mbështetje me fonde dhe tarifa, duke siguruar një balancë të drejtë midis kapaciteteve të UNIKO dhe kërkesave të tregut. Përveç kësaj, është e rëndësishme që kjo strategji të jetë në përputhje me orientimet e përgjithshme strategjike të shtetit dhe të arsyetojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të programit të studimit. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Dok_Aneks 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Dok_Aneks 2.4 Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë</i>			
Konkluzione	GVJ ka konstatuar se studentët e programit të studimit nuk kishin informacione se kush i përfaqëson ata në strukturat e tyre qeverisëse. Në këtë kuadër, GVJ i sugjeron IAL-së që, pas çdo lloji vlerësimi dhe analize, të merren masat e nevojshme dhe konkrete, të cilat duhet të përcaktohen në kohë dhe të implementohen pa vonesa. Po ashtu, është e rëndësishme që pas çdo semestri të vlerësohet progresi ose regresi i programit dhe të bëhen axhustimet e nevojshme për përmirësimin e tij. Gjithashtu, GVJ sugjeron që IAL të identifikojë dhe zhvillojë strategjitë e nevojshme për rritjen e numrit të studentëve në këtë program studimi, duke siguruar ruajtjen e cilësisë. Kjo duhet të bazohet në një analizë të zhvillimeve dhe nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Rritja e numrit të studentëve duhet të ndodhë brenda kapaciteteve të UNIKO, duke marrë parasysh mundësitë për mbështetje financiare, tarifa dhe gjithashtu duke u orientuar nga strategjitë e përgjithshme kombëtare të zhvillimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të	Sipas informacionit të ofruar në RVB, politikat dhe praktikat që lidhen me sigurimin e cilësisë në UNIKO janë të aksesueshme për të gjithë komunitetin brenda universitetit, përfshirë studentët, duke respektuar lirinë akademike dhe

Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	etikën, si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Politikat dhe strategjitë që mbështesin sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë të harmonizuara me Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO. Aktivitetet dhe organizimi i punëve në kuadër të sigurimit të cilësisë janë të rregulluara dhe dokumentuara në Statutin e UNIKO, Rregulloren e UNIKO, Manualin e Cilësisë të UNIKO dhe Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë (FE). Të gjitha këto dokumente janë të disponueshme për publikun në faqen zyrtare të UNIKO. NJSBC, si pjesë e këtij procesi, përgatit dhe publikon rregullisht raporte të brendshme vlerësimi, të cilat ruhet në arkivat e FE dhe UNIKO dhe janë të disponueshme për palët e interesuara. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 2.4 Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstaton se UNIKO publikon rezultatet e vlerësimeve të brendshme të cilësisë së programeve të studimit, duke siguruar respektimin e lirisë akademike dhe etikës, si dhe duke u përpjekur të mbajë të dhënat personale në përputhje me rregulloret për mbrojtjen dhe përpunimin e këtyre të dhënave. Por, GVJ nuk konstaton në RVB për këtë IAL se ka respektuar kërkesat e standardeve duke siguruar transparencë për publikimin edhe në faqen web të UNIKO të të gjitha Relacioneve Përmbledhëse për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve (me përjashtim të vitit akademik 2022-2023, si edhe disa raporte me të dhëna semestrale). Referenca: <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Linku: https://unkorce.edu.al/26223-2/</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Departamenti i Financës-Kontabilitetit, Fakulteti i Ekonomisë dhe UNIKO realizojnë vlerësime të rregullta të rezultateve të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore-shkencore. Raportet e përgatitura pasqyrojnë arritjet në mësimdhënie dhe kërkim gjatë një viti akademik, duke identifikuar gjithashtu sfidat që mund të hasen në aspekte të ndryshme të këtyre aktiviteteve. Kur identifikohen nevojat për përmirësim, Departamenti harton një plan veprimi vjetor për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, i cili përcakton detyrat specifike, përgjegjësitë dhe afatet për realizimin e objektivave të caktuara. Fakulteti i Ekonomisë informon dhe ndërgjegjëson stafin akademik, administrativ dhe studentët mbi rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UNIKO monitoron dhe siguron efektivitetin e veprimtarive që lidhen me vlerësimin e cilësisë, duke përfshirë përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, në përputhje me rregulloret e përcaktuara në Statutin e Universitetit të Korçës dhe Rregulloren e UNIKO.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe	Takimet e Asamblesë së Fakultetit të Ekonomisë dhe ato të anëtarëve të Departamentit janë të rëndësishme për të informuar personelin mbi arritjet dhe

përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	vlerësimet e programeve të studimit dhe për të identifikuar nevojat për përmirësim. Takimet midis Dekanatit dhe Këshillit Studentor janë të dedikuara për të marrë opinionet e studentëve në lidhje me ndryshimet në programet e studimit, metodologjinë e mësimdhënies, metodat e vlerësimit dhe cilësinë e shërbimeve. Organizimi i pyetësorëve studentor ka si qëllim jo vetëm vlerësimin e cilësisë, por edhe ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë e procesit të sigurimit të cilësisë. Referenca: <i>Dok_Aneks 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dok_Aneks 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.3 Plan strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 1.19 Kodi i etikës së UNIKO</i> <i>Dok_Aneks 2.2 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se UNIKO publikon rezultatet e vlerësimeve të brendshme të cilësisë së programeve të studimit, duke siguruar respektimin e lirisë akademike dhe etikës. Megjithatë, GVJ këshillon që UNIKO të publikojë gjithashtu të gjitha Relacionet Përmbledhëse për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në
“Bankë dhe Sigurime” të ofruar nga institucioni i arsimit të lartë Universiteti “Fan S.
Noli”, Korçë**

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse, për këtë program studimi. *(Standardi I.2)*
2. Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, dëshmojnë se kanë kapacitetet e dhe përvojën e duhur në fushën akademike e mësimdhënëse. *(Standardi I.2 dhe II.2).*
3. Marrëveshjet e bashkëpunimit që IAL ka me institucione publike, sipërmarrje dhe biznese private, lehtësojnë dhe mundësojnë kryerjen e praktikave profesionale si dhe punësimin në të ardhmen e studentëve në këtë programi studimi. *(Standardi I.3 dhe III.6).*
4. Struktura dhe plani mësimor i këtij program studimi, synojnë të përcjellin tek studentët formimin teorik dhe praktik si dhe kompetencat profesionale në funksion të punësimit të tyre në tregun e punës. *(Standardi II.4).*
5. Institucioni, disponon mjediset e nevojshme fizike dhe laboratorike për të realizuar sa më mirë procesin e mësimdhënies dhe praktikave mësimore për studentët e këtij programi studimi *(Standardi IV.2).*
6. Qëndrueshmëria e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, për të gjithë periudhën e akreditimit, me kontrata pa afat të punësimit dhe shlyerjen e detyrimeve financiare. *(Standardi IV.1)*
7. Vënia në dispozicion e bibliotekave që institucioni zotëron në përdorim të komunitetit jashtë IAL-së duke mundësuar publikut përdorimin e tyre. Kjo konsiderohet si praktikë pozitive për të krijuar lidhje me pretendentët jashtë IAL-së. *(Standardi IV.3)*
8. IAL siguron transparencë përmes publikimit në website të tij, të raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe disa analiza të gjetjeve nga përgjigjet e pyetësorëve të studentëve. *(Standardi VI.2)*

Pika të dobta:

1. Programi i studimit ka një shpërndarje të krediteve në kategoritë e vëprimitarive formuese, të cilat nuk ruajnë balancën ndërmjet disiplinave përkatëse. *(Standardi II.1)*
2. Niveli i ulët i angazhimit të njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi dhe i personelit akademik, në aktivitete shkencore dhe botime të publikuara në revista shkencore të indeksuara me faktor impakti, si edhe mungesa e përfshirjes së studentëve të këtij programi studimi, në projekte kërkimore dhe në veprimtari akademike shkencore. *(Standardi II.6; Standardi IV.1)*
3. Mungesa e literaturës bazë, qoftë edhe në versionin e ciklit të leksioneve në formatin fizik, në funksion të këtij programi studimi. *(Standardi IV.3)*

4. Mosadresimi i rekomandimit të dhënë nga KLSH për marrjen e masave për adresimin e gjetjeve sipas raportit përfundimtar të auditimit (2023): *“IAL-të duke mos e njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi E-Learning e miratuar nga Këshilli i Ministrave të vendeve anëtare të BE-së...dëshmojnë se kanë mangësi lidhur me informacionin që lidhet me praktikën e e-learning...”*. (Standardi IV.4)
5. Mungon analiza e kostos për student për këtë program studimi me qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për mirëmenaxhimin e fondeve të marra nga buxheti i shtetit dhe orientimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturën e UNIKO në arritjen e misionit të tij përmes analizës dhe përcaktimit të strategjive konkrete për çdo njësi bazë dhe program studimi. Ndërkohë që kosto mesatare për student "Grant i Buxhetit të Shtetit" ka tendencë rritje. (Standardi IV.5)
6. Mungesa e një strategjie të aplikueshme për rritjen e numrit të studentëve në këtë program studimi përmes ruajtjes së cilësisë. (Standardi VI.4)

Rekomandime:

1. Institucioni, të rishikojë shpërndarjen e krediteve në kategoritë e veprimtarive formuese, për të ruajtur balancën ndërmjet disiplinave përkatëse, dhe harmonizuar njohuritë teorike me ato praktike, në përputhje me kërkesat e tregut të punës. (Standardi II.1)
2. Institucioni, të marrë masa për rritjen e mbështetjes së personelit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi, në kuadër të publikimit në revista me faktor impakti, pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore shkencore dhe përfshirjen e studentëve në këto aktivitete. (Standardi II.7; Standardi IV.1)
3. Institucioni, të përditësojë menjëherë bibliotekën me literaturë bazë, qoftë edhe në versionin e ciklit të leksioneve në formatin fizik për këtë program studimi. (Standardi IV.3)
4. Institucioni, të adresojë rekomandimin e dhënë nga KLSH për marrjen e masave për adresimin e gjetjeve sipas raportit përfundimtar të auditimit (2023): *“IAL-të duke mos e njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi E-Learning e miratuar nga Këshilli i Ministrave të vendeve anëtare të BE-së...dëshmojnë se kanë mangësi lidhur me informacionin që lidhet me praktikën e e-learning...”*. (Standardi IV.4)
5. Të kryhet analiza e kostos për student për programin e studimit me qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për mirëmenaxhimin e fondeve të marra nga buxheti i shtetit. (Standardi IV.5)
6. Të hartohet një strategji e aplikueshme për rritjen e numrit të studentëve në këtë program studimi përmes ruajtjes së cilësisë bazuar në analizën e zhvillimeve dhe nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë në rrafshin lokal, rajonal, dhe kombëtar brënda kapaciteteve të UNIKO, mundësisë për mbështetje me fonde dhe tarifa, si edhe marrjes në konsideratë të orientimit strategjik të përgjithshëm kombëtar. (Standardi VI.4)
7. Institucioni, të përditësojë në mënyrë periodike përmbajtjen e programit të studimit, mbështetur në sugjerimet dhe propozimet e ekspertëve të institucioneve partnere me qëllimin rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës. (Standardi II.5)

8. Institucioni, të përshtasë formatin e syllabuseve të këtij programi studimi, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. *(Standardi II.3 dhe II.4)*
9. Institucioni, të rishikojë strukturën dhe planin mësimor të këtij programi studimi, sa i përket kohëzgjatjes së zhvillimit të praktikës profesionale, me qëllim pajisjen e studentëve me njohuri dhe kompetenca të plota profesionale, dhe përshtatjen sa më shpejt me kërkesat e tregut të punës. *(Standardi III.6)*
10. NJSBC të mbajë evidenca për të reflektuar ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të dhëna nga raportet e posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, etj. *(Standardi VI.1)*

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in
"Banking and Insurance" provided by the higher education institution University "Fan S.
Noli" Korça**

Strengths and affirmations:

1. The study program aligns with the academic field of both the main and the base academic unit responsible for its delivery. *(Standard I.2)*
2. The main and base units responsible for offering this study program demonstrate sufficient capacity and experience in the academic and teaching field. *(Standards I.2 and II.2)*
3. Cooperation agreements between the Higher Education Institution (HEI) and public institutions, enterprises, and private businesses facilitate and enable the performance of professional practice as well as future employment of students in this study program. *(Standards I.3 and III.6)*
4. The structure and curriculum of this study program aim to provide students with both theoretical and practical training, as well as professional competencies to support their employment in the labor market. *(Standard II.4)*
5. The institution possesses the necessary physical and laboratory facilities to effectively carry out the teaching process and practical training for students in this program. *(Standard IV.2)*
6. The academic staff engaged in this study program is stable throughout the accreditation period, employed on indefinite-term contracts, and with fulfilled financial obligations. *(Standard IV.1)*
7. The institution allows public access to its libraries, enabling external community members to use them. This is considered a positive practice for establishing connections beyond the HEI. *(Standard IV.3)*
8. The HEI ensures transparency through the publication on its website of internal evaluation reports and analyses of findings from student questionnaire responses. *(Standard VI.2)*

Weaknesses:

1. The distribution of credits across formative activity categories in the study program does not maintain a proper balance among relevant disciplines. *(Standard II.1)*
2. Low level of engagement by the responsible base unit and academic staff in scientific activities and publications in indexed journals with impact factor, as well as lack of student involvement in research projects and academic-scientific activities. *(Standards II.6 and IV.1)*
3. Lack of core literature, even in the form of physical lecture cycles, to support this study program. *(Standard IV.3)*
4. Failure to address the recommendation from the State Supreme Audit Institution (KLSH) to take measures based on the final audit report (2023): "HEIs, by not acknowledging Resolution 2001/C 204/02, known as the E-Learning Resolution adopted by the Council of

Ministers of EU member states... demonstrate shortcomings in information related to e-learning practices.... (Standard IV.4)

5. Absence of cost-per-student analysis for this program, hindering financial management of state-budget funds and the strategic orientation of UNIKO's resources. Meanwhile, the average state-funded grant per student is showing an increasing trend. *(Standard IV.5)*
6. Lack of an applicable strategy for increasing student enrollment in this program while maintaining quality. *(Standard VI.4)*

Recommendations:

1. The institution should revise the credit distribution across formative activity categories to maintain balance among disciplines and harmonize theoretical and practical knowledge in line with labor market requirements. *(Standard II.1)*
2. The institution should take steps to enhance academic staff and student support for publishing in impact-factor journals, participating in scientific research activities, and involving students in such activities. *(Standards II.7 and IV.1)*
3. The institution should immediately update the library with core literature, including at least the physical format of lecture cycles for this program. *(Standard IV.3)*
4. The institution should address the recommendation given by KLSH regarding the adoption of measures to respond to findings from the final audit report (2023): "HEIs, by not acknowledging Resolution 2001/C 204/02, known as the E-Learning Resolution adopted by the Council of Ministers of EU member states... demonstrate shortcomings in information related to e-learning practices...". *(Standard IV.4)*
5. A cost-per-student analysis should be conducted for this study program to perform the necessary evaluations for effective management of state budget funds. *(Standard IV.5)*
6. Develop an applicable strategy to increase student enrollment in this study program while maintaining quality, based on analysis of developments and needs of the local, regional, and national economy and society, within UNIKO's capacities and funding possibilities, and in accordance with the national strategic orientation. *(Standard VI.4)*
7. The institution should regularly update the content of the study program based on feedback and proposals from partner institutions' experts, aiming to improve student employment opportunities in the labor market. *(Standard II.5)*
8. The institution should adapt the syllabi format of this study program in compliance with current sub-legal acts. *(Standards II.3 and II.4)*
9. The institution should revise the structure and curriculum of the study program in regard to the duration of professional practice to ensure students acquire comprehensive professional knowledge and skills and adapt effectively to labor market demands. *(Standard III.6)*
10. The Internal Quality Assurance Unit (NJSBC) should maintain records to reflect the follow-up of implementation of recommendations from special reports on the quality assurance of study programs, as part of the internal quality assurance system structures. *(Standard VI.1)*

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X